



KOMITETI I
HELSINKIT PËR
TË DREJTAT E
NJERIUT

TETOR 2020

RAPORT I VEÇANTË

PËR GJENDJEN E

TË DREJTAVETË NJERIUT

NË KOHËN E KOVID -19

#STAYHOME

1.5m

1.5m

1.5m



British Embassy
Skopje



RRITJA E
PRODUKTIVITETIT
PËRMES PËRMIRËSIMIT
TË LEGJISLACIONIT
PËR MARRËDHËNIE
PUNE NË MAQEDONI

Ky produkt është hartuar në kuadër të projektit “Rritja e produktivitetit nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor mbi marrëdhëniet e punës në Maqedoninë e Veriut”, financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar me mbështetjen e Ambasadës Britanike Shkup. Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin ose mendimet e Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

Botues:

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, përfaqësuar nga kryetari i Këshillit Drejtues, Prof. Dr. Gordan Kallajxhiev

Redaktore:

Uranija Pirovska

Përkthyes:

Shenasi Jaji

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.72/.73:[616.98:578.834(497.7)]"2020"(047)\ .

RAPORT i veçantë për gjendjen e të drejtave të njeriut në kohën e Kovid-19 / [redaktore Uranija Pirovska ; përkthyes Shenasi Jaji]. - Shkup : Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut, 2020. - 33 стр. : илустр. ; 26 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4790-74-7

а) Човекови права - Ковид-19 - Македонија - 2020 - Извештаи
COBISS.MK-ID 52116229

PËRMBAJTJA

6

HYRJE

8

TË DREJTAT E PUNËTORËVE

- 9 Largimi i grupeve të tëra të punëtorëve nga puna dhe marrëveshjet e imponuara
- 10 Masat qeveritare ishin vështirë të zbatueshme në praktikë
- 11 Dimensioni gjinor i krizës së punës
- 12 Dekretet për zbatimin e Ligjit për marrëdhëniet e punës
- 13 Punonjëset në punëtoritë e tekstilit
- 14 Efikasiteti i Inspektoratit Shtetëror të Punës
- 14 Marrja e masave për mbrojtjen e punëtorëve

16

DHUNA NË FAMILJE

20

GRUPET E RREZIKUARA

- 20 Persona në rrezik social
- 22 Mbrojtja e fëmijëve – kontaktimi me prindin
- 23 Personat e pastrehë
- 23 Personat në moshë



25

PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

- 25 Rrezikshmëri e shumëfishtë
- 26 Lëvizja e lirë
- 27 Ndihmë dhe mbështetje
- 27 Arsimi (Jo)inkluziv

29

PERSONAT E PRIVUAR NGA LIRIA

32

KOMUNITETI LGBTI

35

VEPRIMI INSTITUCIONAL

- 35 Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- 36 Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- 37 Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve

ПРЕВЕНЦИЈА ОД ШИРЕЊЕ НА ВИРУСОТ КОВИД-19



Граѓаните на кои им е потребна
бесплатна правна помош да се обратат **САМО**



02 3119 073

072 278 436



helkom@mhc.org.mk

за итни и неодложни правни проблеми телефонски ќе закажеме
средба во нашата канцеларија



HYRJJE

Pandemia e virusit KOVID-19 ka shkaktuar efekte globale në përmasa të pakrahasueshme me çfarëdo ngjarje tjetër në historinë e njerëzimit. Kriza shëndetësore në rritje të shpejtë, e cila i ka goditur pothuajse të gjitha vendet në botë, po shkakton pasoja të paparashikueshme ekonomike dhe sociale, nga të cilat njerëzimi gjatë kohë nuk do të rimëkëmbet. Duke marrë parasysh seriozitetin dhe rrjedhën e pasigurt të ngjarjeve, shumë qeveri, ndër to edhe e jona, e konsideruan të nevojshme shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme për t'u përballur plotësisht me rreziqet dhe dëmet nga virusi i ri korona. Dhe, meqenëse gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, Qeveria mund të ndërmarrë veprime përtej asaj që lejohet në kushte normale, kjo gjithashtu nënkuptonte një alarm për të shtuar vigjilencën mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

Pasi Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut e firmosi Dekretin për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme më 18 mars 2020, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, vuri në dukje publikisht se gjendja e jashtëzakonshme në asnjë rast nuk guxon të jetë justifikim që autoritetet përgjegjëse t'i shkelin të drejtat e njeriut.

Komiteti theksoi se masat që do të merren nuk duhet të devijojnë nga detyrimi për të mbrojtur kategoritë më të rrezikuara të qytetarëve dhe se të drejtat dhe liritë e njeriut duhet të merren në konsideratë. Gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme, shteti nuk duhet të parandalojë arbitrarisht ushtrimin e të drejtave të njeriut ose arbitrarisht të kufizojë liritë e njeriut, për ofrimin dhe mbrojtjen e të cilave është vetë përgjegjës. Komiteti i Helsinkit, gjithashtu paralajmëroi se në përputhje me standardet vendore dhe ndërkombëtare, kufizimi i të drejtave dhe lirive në asnjë rast nuk duhet të jetë diskriminues për shkak të seksit, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, origjinës etnike ose sociale, pronës ose statusit shoqëror. Ndërhyrja arbitrare do të ishte në kundërshtim me interesin publik dhe të mirën e përbashkët, dhe kështu dekretet qeveritare me fuqi ligjore do të ishin në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

(постерот на кардула за работа на ХК во нови услови)

Edheparashpalljessëgjendjessëjashtëzakonshme, Komiteti i Helsinkit e kishte riorganizuar punën e

tij në përputhje me rekomandimet për parandalim të Ministrisë së Shëndetësisë. Mundësuam funksionim të pandërprerë të shërbimit për ndihmë juridike falas për qytetarët përmes telefonit dhe postës elektronike, duke lënë mundësi edhe për takime të drejtpërdrejta për rastet urgjente. Andaj, duke marrë parasysh se kufizimet e lirisë së lëvizjes dhe kriza ekonomike nënkuptonin një goditje të pashmangshme mbi të drejtat e njeriut, Komiteti u përqëndrua në monitorimin e

Ky raport bazohet në të dhënat e regjistruara nga Komiteti në komunikimin e përditshëm me qytetarët që kërkojnë ndihmë juridike, në analizën e efekteve të dekreteve të miratuara qeveritare në këtë periudhë krize, si dhe në monitorimin e rregullt të situatës në sfera të caktuara.

Kriza shëndetësore është larg përfundimit, kurse kriza ekonomike dhe sociale do të intensifikohet me kalimin e çdo dite të pasigurisë



të drejtave të punëtorëve, të drejtat e grupeve të rrezikuara dhe të marginalizuara dhe atyre të privuar nga liria gjatë kohës së pandemisë. Përveç kësaj, organizata ishte vazhdimisht aktive përmes rrjeteve në të cilat ajo është anëtare, kurse gjatë periudhës së kaluar i mbështeti edhe iniciativat e përbashkëta për mbrojtjen e punëtorëve.

dhe kufizimeve të imponuara. Si rezultat i kësaj, shpesojmë se ky raport i veçantë do të shërbejë si dokument orientues për veprimin e mëtejshëm të vendimmarrësve, sepse me saktësi përcakton se cilat të drejta janë shkelur më shumë gjatë periudhës së kaluar kritike dhe ku nevojitet ndërhyrje urgjente dhe efikase për të parandaluar dëmet e mëtutjeshme.



10 MARS - 30 QERSHOR

Ndhmë juridike falas

197

Raste

2723

Punëtorë

1

Punëdhënës

Statistika gjinore


39.09%

Punonjës

60.91%

Punonjëse

Qytetet



Shkelje më të shpeshta

	Denoncime ¹	Punëtorë ²
Largime nga puna	44	460
Marrëveshje të detyruara	39	323
Shkelje të tjera	38	38
Mospagim të pagave dhe/ose ulje të pagave	35	912
Shkelje të masave qeveritare ³	23	1022
Shfrytëzim i detyruar i pushtimit vjetor dhe/ose pushtim pa pagesë	12	12
Mosvazhdim i kontratave për kohë të caktuar	10	10
Mosvazhdim i kontratave për kohë të caktuar për punonjëset shtatzënë	6	6

¹ Numri i përfshirjes së denoncimeve/punëtorëve i shfaqur këtu është me i madh se numri i rasteve/përshirjeve të regjistruara të punëtorëve, sepse disa raste kanë të bëjnë me më tepër shkelje për një kohë.

² Punëtorët denoncuan personalisht për vete, por me atë shkelje mund të përfshihen më tepër punëtorë.

³ Masa për t'iu larg nga puna të pushtimit me shprehje kronike, punëtorëve shtatzënë dhe prindërit të fëmijëve deri në moshën 10-vjeçare dhe masa për organizimin e procesit të punës në përputhje me rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë (distanca, dezinfektimi).

Këshilla juridike



- Këshillim që të mos nënshkruhen marrëveshje.
- Parashtrim të kundërshtimit ndaj vendimit për largim nga puna.
- Përdorimi i mekanizmave mbrojtës, kryesisht Inspektorati Shtetëror i Punës.
- Sqarime të masave të miratuara nga Qeveria që kanë të bëjnë me punëtorët.
- Këshillim për kompensimet në rast të papunësisë.
- Parashtrim të padive penale për shkak të shkeljes së të drejtave nga marrëdhënia e punës.
- Hedhja poshtë e largimit nga puna me gojë për shkak të mangësive në lidhje me: formën dhe përmbajtjen e largimit nga puna, mënyrën e dorëzimit, arsyetimin dhe obligimin për dëshim.
- Informacion tjetër juridik për ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

TË DREJTAT E PUNËTORËVE

Virusi korona shkaktoi një krizë shëndetësore, por edhe kizë pune. Punëtorët ishin të parët që u goditën pas shpallje së gjendjes së jashtëzakonshme për shkak të përballjes me pasojat e virusit korona. Gjendja e krizës për ta nënkuptonte një luftë për të ruajtur shëndetin e tyre dhe të familjarëve, por edhe një luftë për të shpëtuar ekzistencën e tyre.

Menjëherë pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, ishim dëshmitarë të shkeljeve të vrazhda të të drejtave të punëtorëve, numri i të cilave rritej për çdo ditë. Gjatë kohës së gjendjes së krizës, Komiteti i Helsinkit vazhdoi pandërprerë të ofronte ndihmë juridike falas për të gjithë punëtorët.

Në periudhën prej 10 mars e deri më 15 maj, në Komitetin e Helsinkit u denoncuan 152 raste të shkeljeve të të drejtave nga marrëdhënia e punës,¹ duke prekur 2.481 punëtorë.²

1 Përshkrimi i rasteve, i ndarë në katër raporte periodike në formë infografikësh në dy javë, në dispozicion në: <https://mhc.org.mk/specijalni-izvestai/>.

2 Përfshirja e punëtorëve definohet në bazë të numrit të punonjësve që janë prekur me shkeljen e denoncuar

Largimi i grupeve të tëra të punëtorëve nga puna dhe marrëveshjet e imponuara

Punëdhënësit filluan menjëherë me largimet masive të punëtorëve nga puna, respektivisht ndërprerjen e kontratave të tyre të punësimit, ndërsa në organizatën tonë u denoncuan 37 raste të tilla, që përfshinin përafërisht 453 punëtorë.³ Zvogëlimi i vëllimit të punës ishte arsyeja pse disa nga punëdhënësit, pa i njoftuar fare punëtorët, anuluan kontratat e tyre të punës për arsye afariste. Në disa raste, punëtorëve u ishte thënë me gojë që të mos vinin në punë, pa u njoftuar me shkrim.

Atje ku kishin mundësi, punëdhënësit ndikonin mbi punëtorët që t'i firmosin marrëveshjet për ndërprerjen e kontratave të tyre. Disave prej tyre, kontratat u janë ndërprerë me falsifikim ose përdorimin e nënshkrimeve të tyre, paraprakisht të vëna në fletë të bardha boshe. Pa vullnetin e tyre, 321 punëtorë në 35 raste kanë firmosur marrëveshje për ndërprerjen e marrëdhënies së tyre të punës. Në këtë mënyrë, atyre iu është mohuar çdo qasje në një mekanizëm mbrojtës dhe ata mbetën të luftonin për një ekzistencë «të zhveshur» në margjinat e shoqërisë.

Pastaj, për të shmangur përdorimin e mekanizmave ligjorë në rast të pushimit nga puna, të shpeshta ishin edhe denoncimet e rasteve kur punëdhënësit të caktuar u kanë ofruar punëtorëve, punonjësve me kohë të pacaktuar pune, që të firmosin kontrata të reja, në kohë të caktuar. Nga ana tjetër, ata që ishin tashmë në marrëdhënie pune me kontrata punësimi për kohë të caktuar ishin ndër punëtorët më të pambrojtur. Në 12 raste, kontratat e tyre të punësimit nuk ishin vazhduar, përfshi këtu edhe punonjëset shtatzënë, të cilat për shkak të gjendjes së re të krijuar e kanë humbur edhe të drejtën e pushimit të lehonisë.

Vështirësitë në punë, veçanërisht në sektorë të tillë si hotelieria, turizmi, prodhimi i veshjeve dhe këpucëve, tregtia dhe të ngjashme, ishin arsye që pagat e mijëra punëtorëve të ulen, ndërsa disave të mos u paguhet fare. Vetëm në Komitetin e Helsinkit u regjistruan 24 raste të tilla, që përfshinë pothuajse 702 punëtorë.

³ Të dhënat janë sublimat i raporteve periodike që do të jenë çështje e një analize më të hollësishme në testin e mëposhtëm.



Masat qeveritare ishin vështirë të zbatueshme në praktikë

Nuk u kursyen as ata punëtorë që u liruan nga detyrat e punës në përputhje me masat e Qeverisë.⁴ Personat me sëmundje kronike, punonjëset shtatzënë dhe prindërit e fëmijëve deri në moshën 10 vjeç, të cilët ishin të liruar nga detyrat e tyre të punës, u përballën me një ulje 50% të pagave të tyre. Përveç kësaj, Komiteti i Helsinkit ka regjistruar edhe raste në të cilat punëdhënësit nuk i kanë liruar fare punëtorët nga detyrat e punës që hyjnë në këtë kategori.

Numër i madh punëdhënësish nuk i respektonin masat dhe rekomandimet e Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për parandalim dhe mbrojtje nga virusi korona. Veçanërisht të pambrojtur dhe të rrezikuar ishin punëtorët në linjën e parë të frontit kundër virusit, punëtorët e supermarketeve, shitësit dhe shitëset. Punëdhënësit nuk u kanë siguruar pajisje të duhura për mbrojtje, ashtu që ata i kryenin detyrat e tyre të punës duke u ekspozuar në rreziqe serioze për shëndetin dhe jetën e tyre. Për më tepër, ata nuk përfituan rritje të pagave në përpjestim me rrezikun e shtuar në vendin e punës. Komiteti i Helsinkit shkelje të tilla ka regjistruar në 19 raste, që përfshinë afërsisht 1.018 punëtorë.

Më kritike ishin dy javët e para pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, kur u regjistruan numri më i madh i shkeljeve të të drejtave të punëtorëve, respektivisht 60 raste që përfshinë afërsisht 1.554 punëtorë.⁵ Në muajin maj, numri i rasteve të denoncuar u zvogëlua në 12. Në periudhën kur u regjistruan numri më i madh i shkeljeve, nga 10 deri më 31 mars, u pushuan nga puna 375 punëtorë, për dallim nga gjysma e parë e muajit prill kur nga puna u pushuan 67 punëtorë.⁶

4 Kategoritë e punëtorëve që u liruan nga detyrat e punës në përputhje me masat e Qeverisë janë në dispozicion në këtë link: <https://koronavirus.gov.mk/merki/mtsp>.

5 Raport dyjavor për gjendjen e të drejtave të punëtorëve në kohën e virusit korona për periudhën prej 10 deri në 31 mars 2020, në dispozicion në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2020/03/1-infographic-mkd.pdf>.

6 Raport dyjavor për gjendjen e të drejtave të punëtorëve në kohën e virusit korona për periudhën prej 1 deri në 14 prill 2020, në dispozicion në: https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2020/04/2_infographic_mk-1.pdf.

Numri i largimeve nga puna filloi të zvogëlohet, kështu që nga mesi i prillit deri në mesin e majit u regjistruan gjithsej 11 punëtorë të pushuar nga puna.⁷ U zvogëlua edhe numri i anulimit të kontratave të punësimit me marrëveshje të imponuara, gjersa në muajin mars 53 punëtorë kishin firmosur marrëveshje të tilla kundër vullnetit të tyre, në muajin maj tashmë ky numër u zvogëlua në 3 punëtorë. Tendencia e njëjtë vlen edhe për shkeljet e masave qeveritare dhe Ministrisë së Shëndetësisë, denoncime që u reduktuan nga 1.007 punëtorë të përfshirë në vetëm 1 punëtor. Zvogëlimi i shifrave me shumë gjasë është rezultat i presionit të madh të opinionit, sindikatave dhe sektorit civil. Megjithatë, ndikim të madh kishte edhe puna e Inspektoratit Shtetëror të Punës, i cili edhe pse kishte vëllim të shtuar të punës, tregoi profesionalizëm dhe efikasitet në zbatimin e mbikëqyrjeve të jashtëzakonshme inspektuese të punëdhënësit dhe konstatimit të shkeljeve të drejtave të punëtorëve.

Me kalimin e kohës, vazhdoi të rritet vetëm tendencia e uljes dhe mospagimit të pagave të punëtorëve. Derisa në javët e para ishin regjistruar gjithsej 3 denoncime për shkelje të tilla, duke përfshirë afërsisht 102 punëtorë, në gjysmën e dytë të muajit prill kjo shifër u rrit dhe arriti në 538 punëtorë. Shkeljet e këtilla të drejtave të punëtorëve, punëdhënësit i arsyetonin duke u thirrur jashtëligjshëm në institutin „forcë mbinatyrore”.

Dimensioni gjinor i krizës së punës

Pothuajse dy të tretat e të gjitha rasteve janë gra punëtoresh, prandaj nuk mund të mos konkludojmë se kriza ka marrë një dimension gjinor. Kjo për faktin se pjesa më e madhe e të punësuarve në sektorët që ishin më të prekur nga kriza siç janë hotelieria, dyqanet për veshje dhe këpucë, parukieret dhe sallonet e bukurisë, janë gra.⁸ Është e pashmangshme të mos përmendet edhe fakti se gratë zakonisht themelojnë marrëdhënie pune me kontratë punësimi për kohë të caktuar, për dallim nga burrat, prandaj për shkak të krizës në të shumtën e rasteve kontratat e tyre të punësimit nuk u vazhduan nga ana e punëdhënësve.⁹

Komiteti i Helsinkit vazhdimisht ka bërë thirrje dhe i ka këshilluar punëtorët që të mos firmosin marrëveshje për ndërprerjen e kontratave të tyre të punësimit, kurse atyre punëtorëve që janë larguar nga puna me shkrim, Komiteti u ka ndihmuar në lidhje me parashtrimin e kundërshtimeve të punëdhënësit. Punëtorët u këshilluan të përdorin mekanizmat mbrojtës siç është Inspektorati Shtetëror i Punës në rast të shkeljes së të drejtave të tyre, dhe në një rast Komiteti i këshilloi ata mbi mundësinë e ngritjes së aktakuzave penale kundër punëdhënësit për shkelje të të drejtave nga marrëdhëniet e punës. Përpos kësaj, punëtorëve u janë shpjeguar masat dhe rekomandimet e miratuara nga Qeveria, dhe një nga pyetjet më të zakonshme kishte të bëjë me kushtet dhe mënyrën e ushtrimit të së drejtës për përfitime monetare në rast të papunësisë.

7 Raport dyjavor për gjendjen e të drejtave të punëtorëve në kohën e virusit korona për periudhën prej 15 deri në 28 prill 2020, në dispozicion në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2020/04/info-3-mk.pdf> dhe për periudhën prej 29 prill deri në 15 maj, në dispozicion në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2020/05/infografika4-mk.pdf>.

8 Të dhënat tregojnë se ka më shumë të punësuar gra në kategorinë „Veprimtari të tjera shërbyese” sesa burra. Enti Shtetëror i Statistikës, MAKStat-baza e të dhënave „Të punësuar sipas marrëdhënies së punës, sipas KKV Rev. 2, sipas gjinisë, sipas viteve”.

9 Në vitin 2018, 28 % e grave ishin me kontratë punësimi për kohë të caktuar, për dallim nga burrat që në 23,9 % të rasteve kanë pasur kontratë të tilla. Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, MAKStat-baza e të dhënave „Të punësuar sipas marrëdhënies së punës, sipas KKV Rev. 2, sipas gjinisë, sipas viteve”.

Dekretet për zbatimin e Ligjit për marrëdhëniet e punës

Gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi dy dekrete me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për marrëdhëniet e punës.

Dekreti i parë me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për marrëdhëniet e punës gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme ishte miratuar në datë 02.04.2020. Me këtë Dekret u zgjat afati për kthimin e punëtorëve në punë në rastet kur punëtorët ishin penguar ose nuk mund t'i kryenin punët në rastet e parashikuara me ligj, si për shembull punëtorët që kishin shfrytëzuar pushim mjekësor. Dekreti gjithashtu e ndryshoi edhe shfrytëzimin e pushimit të pjesës tjetër të punëtorëve në sektorin privat të përfshirë me masat e përkohshme për mbrojtjen dhe përhapjen e KOVID-19. Në përputhje me ndryshimet, punëtorët e përfshirë do të duhet që pushimin e pashfrytëzuar vjetor për vitin 2019 ta shfrytëzojnë deri në fund të muajit maj të vitit 2020 dhe pjesën e pushimit vjetor për vitin 2020 në kohëzgjatje prej dy javë pune të pandërprera, ta shfrytëzojnë deri në fund të muajit qershor 2020. Dispozita e fundit e rëndësishme e këtij Dekreti parashikon se mungesa nga puna e punonjësës për shkak të shtatzënisë, lehonisë, kujdesit prindëror dhe adoptimit të fëmijës vazhdon të vlejë, kurse kompensimi monetar do të vazhdojë të paguhet deri në përfundimin e kohëzgjatjes së masave të përkohshme për mbrojtje dhe parandalim të përhapjes së KOVID-19.

Dekreti i dytë me fuqi ligjore për plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për marrëdhëniet e punës gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme ishte miratuar në datë 01.05.2020. Me këtë Dekret parashikohet kthimi në punë i punëtorëve që ishin çlajmëruar nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm social nga ana e punëdhënësve. Kjo jep mundësi që të arrihet marrëveshje midis punëdhënësve dhe punëtorëve të çlajmëruar nga sigurimi i detyrueshëm social për periudhën prej 11.03.2020 deri më 30.04.2020, për kthimin e tyre në punë. Dekreti e parashikon edhe procedurën për arritjen e marrëveshjes, kthimin e punëtorëve të çlajmëruar në sistemin e sigurimit të detyrueshëm social dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë e Punësimit.

Punonjëset në punëtoritë e tekstilit

Me hyrjen në fuqi të gjendjes së jashtëzakonshme dhe miratimit të masave dhe dekreteve të reja që u referohen të drejtave të punëtorëve dhe rregullimit të procesit të punës, midis punonjëseve në punëtoritë e tekstilit mbizotëronte një frikë e madhe nga përhapja e virusit. Përmes ndihmës para-juridike, për çdo ditë ishin regjistruar denoncime nga punonjëse në punëtoritë e tekstilit, të cilat shprehnin revoltën e tyre ngase konsideronin se janë të diskriminuara, sepse në sektorët e tjerë tashmë kishte filluar zbatimin e punës nga shtëpia. Ndërsa numri më i madh i ndërmarrjeve kishin shkurtuar orarin e punës dhe kishin ndërmarrë masa mbrojtëse për punëtorët, punonjëset në punëtoritë e tekstilit mbetën të ekspozuara në rrezik të shtuar nga përhapja e virusit në repartet e prodhimit, në të cilët në fillim nuk kishte ndryshime dhe masa të përforcuara për mbrojtje. Kjo gjithashtu vllente edhe për autobusët dhe transportin e punonjëseve në vendin e punës.

Në fillim të gjendjes së jashtëzakonshme nuk kishte dekret të veçantë dhe masa për rregullimin e procesit të punës në repartet prodhuese, prandaj punëtorët dhe punëdhënësit përballeshin me problemin e mungesës së informacionit. Disa prej dilemave që u paraqitën kishin të bënin me faktin nëse punëtorët duhet të mbajnë maska në vendet e punës, vallë duhet dhe si duhet të kryhet dezinfektimi në repartet prodhuese, si të organizohet procesi i punës dhe të ngjashme. Për këto arsye, Komiteti i Helsinkit së bashku me shoqatën “Gllasen Tekstilec” në datë 17.03.2020 mbajtën një takim koordinues në nivel lokal me kryetarin e Komunës së Shtipit, Bllagoj Boçvarski, me punëdhënësin transporti nga shumë punëtori tekstili, me përfaqësues të Inspektoratit Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor (IShSSH) dhe Drejtoreshën e Qendrës për Shëndet Publik

(QShP) ku u prezantuan problemet me të cilët ballafaqohen si punonjëset, ashtu edhe punëdhënësit. Në këtë takim u dhanë propozim-masa nga ana e ISHSSH-së dhe QShP-së që duhet ndërmarrë nga ana e punëdhënësve dhe u arrit marrëveshje që kryetari i Komunës të kërkojë hartimin e udhëzimeve dhe masave të vetme, të cilat duhet ndërmarrë në vendet e punës secili punëdhënësi në sektorin privat. Menjëherë pas këtij takimi, në seancën e Qeverisë u miratuan konkludime dhe masa për mënyrën e organizimit të proceseve të punës dhe masave mbrojtëse që duhet ndërmarrë në vendet e punës.

Gjatë muajve mars dhe prill, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut regjistroi numër të shtuar të shkeljeve të të drejtave të punëtorëve, sidomos të punonjëseve në punëtoritë e tekstilit. Gjatë këtyre dy muajve ishin regjistruar 146 raste shkeljesh të të drejtave të punëtorëve. Numri më i madh i shkeljeve kishin të bënin me organizimin jopërkates të transportit, ku në autobusë u transportonin numër i madh punonjësesh pa reduktuar numrin e udhëtarëve dhe pa distancë të rekomanduar, distancë jo e përshtatshme në repartet e prodhimit dhe „marrëveshje “ të imponuara për anulimin e kontratave të punësimit. Numrit më të madh të punonjëseve në kohë të caktuar nuk iu vazhduan kontratat e punësimit, të cilat kishin nevojë për ndihmë juridike për ushtrimin e të drejtës për kompensim monetar në rast papunësie. Personat me sëmundje kronike nuk u liruan nga puna, andaj edhe ata kishin nevojë për ndihmë juridike sa i përket kërkesës dhe mënyrës së dorëzimit të dokumentacionit përkatës të punëdhënësi për t'i liruar nga puna.

Efikasiteti i Inspektoratit Shtetëror të Punës

Gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme, Komiteti i Helsinkit parashtroi 15 kërkesa për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese për shkelje të të drejtave të punës të punonjëseve në punëtoritë e tekstit:

» 6 kërkesa për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese për mungesën e sigurimit të transportit të organizuar në punë gjatë orës policore, në përputhje me masat qeveritare, mungesën e sigurimit të distancës prej 2 metrash në vendin e punës dhe mungesën e dezinfektimit të hapësirave të punës;

» 4 kërkesa për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese për pagimin e pagave më të ulëta nga ajo e parashikuar me ligj;

» 1 kërkesë për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese për mosrespektimin e rekomandimeve të Qeverisë për lirimin nga puna të njërit prind me fëmijë deri në

moshën 10 vjeç;

» 1 kërkesë për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese për largimet kolektive nga puna;

» 1 kërkesë për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese për firmosjen e vendimeve boshe të pushimit vjetor;

» 1 kërkesë për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese për moslajmërimin e punës gjatë festës shtetërore dhe

» 1 kërkesë për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese për paga të papaguara.

Për 14 prej kërkesave të parashtuara për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese Inspektorati Shtetëror i Punës kishte konstatuar shkelje të drejtave të punës, kurse për 1 prej kërkesave të inicuar, ende nuk kemi përgjigje.

Marrja e masave për mbrojtjen e punëtorëve

Komiteti i Helsinkit qysh më 21 mars 2020 kërkoi urgjentisht të merren masa kundër largimeve nga puna derisa zgjat kriza, sepse në terren tashmë ekzistonin indikacione të forta se disa punëdhënës po e keqpërdorin gjendjen e jashtëzakonshme.¹⁰ Informacionet për anulimin e kontratave të punësimit grupeve të tëra të punëtorëve ose zvogëlimin e konsiderueshëm të pagave u realizuan, dhe shumë punëtorë mbetën pa të ardhurat prej ku i sigurojnë nevojat elementare të jetës. Për këto arsye, Komiteti i Helsinkit së bashku me dhjetëra sindikata dhe organizata të shoqërisë civile dorëzuan një pako kërkesash deri te Qeveria dhe propozime konkrete që si secila prej kërkesave të realizohet më lehtë.¹¹

¹⁰ Në dispozicion në: <https://mhc.org.mk/news/itno-da-se-prezemat-merki-protiv-otpushtanja-od-rabota-dodeka-trae-krizata/>.

¹¹ Në dispozicion në: <https://mhc.org.mk/news/baranja-do-vladata-za-zashtita-na-rabotnicite-i-siromashnite/>

Masat e Qeverisë gjatë tërë periudhës u dukën si të vonuara dhe mbrojtja deklarative e të drejtave të punëtorëve në praktikë shpesh shndërrohej në masa joefikase dhe politika kundërthënëse për përballimin e krizës në tregun e punës. Një shembull i tillë ishte edhe me procesin e ndryshimit dhe plotësimit të Dekretit me fuqi ligjore për mbështetje financiare punëdhënësve në sektorin privat në drejtim të dhënies së mundësisë punëdhënësve që shfrytëzojnë ndihmë financiare nga shteti që të largojnë punëtorë nga puna. Atëherë u kuptua se Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, jo vetëm që nuk i mori në konsideratë kërkesat e parashtruara, por përkundrazi, ndjeshëm e përkeqësoi situatën me ndryshimin e sërishëm të Dekretit. Në datë 29.04.2020, ministrja e financave Nina Angellovska deklaroi se ndërmarrjeve që shfrytëzojnë mbështetje financiare nga shteti për pagimin e pagave do u lejohet të largojnë deri në 15% të të punësuarve të tyre. Komiteti i Helsinkit së bashku me shumë sindikata dhe organizata të shoqërisë civile që luftojnë dhe angazhohen për të drejtat e punëtorëve dhe për jetë të dinjitetshme të punëtorëve, kundërshtuan dhe dënuan fuqimisht këtë deklaratë të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ky ndryshim i këtillë, në veçanti ishte i dyshimtë për shkak se Qeveria paraprakisht një herë e ndryshoi këtë Dekret, duke shkurtuar afatin për moslargimin e punëtorëve nga muaji shtator në korrik, respektivisht për dy muaj.

Në fund, përfaqësimi ishte i suksesshëm sepse Qeveria e tërhoqi Dekretin dhe propozoi ndryshime të reja, të përafruara me propozimet e sindikatave dhe organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Sipas formulimit aktual të atij Dekreti përcaktohet se punëdhënësi mbështetjen financiare do ta shfrytëzojë për pagimin e pagave, nuk guxon të ketë ulje të numrit të të punësuarve në muajt prill dhe maj 2020, si dhe 2 muaj më pas, përfundimisht me muajin korrik të vitit 2020.

Përfundimisht, Qeveria me rastin e prezantimit të paketës së tretë të masave ekonomike, e prezantoi masën „Kompensim monetar për të gjithë personat që kanë mbetur pa punë nga 11 marsi deri më 30 prill 2020 si një formë harmonizimi me kërkesat e sindikatave dhe organizatave të shoqërisë civile. Komiteti i Helsinkit së bashku me shumë organizata të shoqërisë civile dhe sindikata, që nga fillimi i krizës shëndetësore bëri me dije për keqpërdorimet e shumta të anulimit të kontratave të punësimit me „marrëveshje“ dhe deklaratave të imponuara për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësve. Për këtë arsye, shumë punëtorë dhe familjet e tyre mbetën pa asnjë të ardhur dhe pa mundësi për punësim të ri gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme. Me këtë masë, të gjithë personat që kanë humbur vendin e tyre të punës, përfshi edhe ata që kanë ndërprerë marrëdhënien e punës përmes deklaratës me shkrim, marrëveshjes ose pushim nga puna nga punëdhënësi, do të përfitojnë kompensim monetar nga Agjencia e Punësimit, dhe padyshim se kjo ishte një fillim premtues. Me këtë kompensim përfshihen të paktën 8.000 punëtorë, ekzistenca e të cilëve ishte vënë seriozisht në rrezik, sepse u lanë pa bazën e vetme nga e cila realizojnë të ardhura.

Megjithatë, Qeveria nuk e respektoi marrëveshjen e arritur në takimin e 30 prillit, kur u bë marrëveshja që këto persona të përfshihen me zgjidhjen sistimore për sigurimin e rasteve të papunësisë, respektivisht, të përfitojnë kompensim për periudhën varësisht nga stazhi i tyre, e jo vetëm prej 2 muajsh. Me faktin që Qeveria nuk e mbajti fjalën dhe tërhoqi vendimin paraprak, tregoi se sa i respekton punonjëset dhe punonjësit dhe sindikatat si përfaqësues të tyre. Për periudhën në vijim presim që Qeveria të harmonizojë edhe këtë masë me logjikën ekzistuese që qëndron në Ligjin për punësim dhe sigurim në rast papunësie dhe periudhën kohore të sigurimit ta harmonizojë me stazhin, në vend të afatit hë për hë të caktuar prej dy muajsh për të gjithë punëtorët, pavarësisht stazhit të tyre.

DHUNA NË FAMILJE

Paralajmërimet për rrezikun e rritjes së rasteve të dhunës në familje, në kushtet e një krize të përmasave kaq të mëdha, filluan qysh në muajin mars. Megjithëse kishte të dhëna të pamjaftueshme zyrtare për këtë periudhë relativisht të shkurtër, statistikave fillestare nga vendet ku virusi ishte përhapur në mënyrë të konsiderueshme treguan për një rritje të konsiderueshme të dhunës në familje. Ky ishte padyshim një nga efektet negative që lidhen me masat kufizuese për parandalim dhe mbrojtje nga virusi. Fakti që vendet ishin përqëndruar plotësisht në mbrojtjen e tyre nga përhapja e virusit ka kontribuar në mënyrë të pashmangshme në shpërfilljen e sfidave me të cilat përballen shumë qytetarë që tashmë janë në situatë rreziku, si dhe duke e bërë të vështirë qasjen në disa shërbime të caktuara. Në të njëjtën kohë, devijimi i një shume të lartë fondesh në sistemin shëndetësor ishte në kurriz të qasjes në disa të drejta dhe shërbime të caktuara, të cilat prekin grupe të shumta të marginalizuara të qytetarëve.

Vlerësohet se në 162 vende ishin institucionalizuar masat për vetizolim dhe distancim, kështu që rreth 2.73 bilion gra në botë ishin të detyruara t'i respektojnë masat për vetizolim në shtëpi.¹² Nëse do kishim parasysh se edhe në kushte kur nuk ka krizë të kësaj përmase, shtëpia paraqet vendin më të pasigurt për gratë (për çka flasin edhe statistikave të vendit tonë),¹³ rrezikshmëria e grave në vendqëndrimin e tyre është rritur ndjeshëm për kohën e pandemisë.

Masat kufizuese që u miratonin për çdo ditë nga ana e Qeverisë së SMV-së që nga fillimi i pandemisë, ndër to edhe rekomandimet për vetizolim, edhe pse të vlerësuara si mënyrë më e efikase për parandalim, prapë paraqesin faktor serioz për rritjen e rrezikut të sjelljes së dhunshme në shtëpi. Për më tepër, stresi i shkaktuar nga humbja e vendeve të punës, mbyllja e çerdheve dhe shkollave, gjendja e pasigurt financiare, problemet ekzistuese shëndetësore, janë bazë për rritjen e dhunës në familje. Kjo nuk nënkupton vetëm rritje të numrit të rasteve, por rrezik nga intensifikimi i dhunës ekzistuese. Në vendet e Bashkimit Evropian, një nga pesë gra është viktimë e dhunës në familje, kurse rreziku është edhe më i madh për gratë që jetojnë në familje që kanë probleme me plotësimin e nevojave themelore ekzistenciale.¹⁴

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut që nga fillimi i pandemisë u ka bërë thirrje institucioneve që të veprojnë në kohë dhe në mënyrën e duhur sa i përket denoncimeve të dhunës në familje dhe me bazë gjinore, që të parandalohet rritja e tyre dhe pasojat fatale. Ajo që ishte në veçanti e rëndësishme për këtë periudhë është mundësimi i mbështetjes dhe inkurajimit të viktimave për ta denoncuar dhunën, sepse përvojat nga terreni flasin se një ndër problemet kryesore është pikërisht mosdenoncimi. Norma e denoncimeve të rasteve të dhunës është rreth 14% në Evropë,¹⁵ ndërsa në vendin tonë vetëm 2% e grave që kanë përjetuar dhunë nga partneri, e kanë denoncuar të njëjtën në polici,¹⁶ që është rezultat i mosbesimit në institucione,

¹² Në dispozicion në: <https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/womens-empowerment/justice-for-women-amidst-covid-19.html>

¹³ Në dispozicion në: http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2013/11/Femicidi-mk.final_.pdf

¹⁴ Në dispozicion në: <https://eige.europa.eu/news/eu-rights-and-equality-agency-heads-lets-step-our-efforts-end-domestic-violence>

¹⁵ Në dispozicion në: <https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/womens-empowerment/justice-for-women-amidst-covid-19.html>

¹⁶ Në dispozicion në: <https://www.osce.org/mk/secretariat/424409?download=true>

mungesës së sanksionimit të dhunësve, por edhe frikës dhe turp, madje edhe mosidentifikimit të dhunës nga ana e vetë viktimave.

Për sa i përket shërbimeve të raportimit të dhunës në familje, gjatë periudhës së izolimit, viktimat ishin në gjendje të denonconin në Linjën kombëtare celulare falas SOS për viktimat e dhunës në familje, e cila ofron informacion konfidencial 24-orësh për mbrojtjen e viktimave, shërbimet e disponueshme dhe këshillimin telefonik për viktimat, si dhe në stacionin më të afërt të policisë ose Qendrën kompetente për Punë Sociale. Shërbimi për ndihmë juridike falas i Komitetit të Helsinkit ishte në dispozicion të viktimave çdo ditë pune, me orar të shkurtuar pune, si përmes telefonit, ashtu edhe përmes postës elektronike.

Më 9 prill 2020, Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, anëtar i të cilit është Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, dorëzoi një Kërkesë për plotësimin e vendimit për ndalimin e lëvizjes së qytetarëve në të gjithë territorin e vendit¹⁷ te Qeveria e RMV-së, me qëllim që të miratojnë masa me të cilat do të behet përjashtim të sanksionimit të grave-viktima të dhunës dhe fëmijëve të tyre që ikin nga shtëpia për shkak të kërcënimit dhe rrezikut të drejtpërdrejtë nga dhuna. Shumë shpejt pas dorëzimit të kërkesës, Ministria e Punëve të Brendshme publikoi një komunikatë,¹⁸ duke njoftuar se viktimat e dhunës, gjatë orës policore do të mund pandërprerë të lëvizin deri në stacion më të afërt policor ose në rast se kanë nevojë për ndihmë shëndetësore, deri te institucioni më i afërt shëndetësor, respektivisht nuk do të kenë nevojë për leje të posaçme të lëvizjes për këto nevoja.

Më 13 prill 2020, Rrjeti dorëzoi në Qeverinë e RMV-së edhe Kërkesë zyrtare për shqiptimin

¹⁷ Në dispozicion në: <https://mhc.org.mk/news/baranje-do-vlada-na-rsm-za-dopolnuvanje-na-odlukata-za-zabrana-za-dvizhenje-na-graganite-vo-celata-teritorija-na-drzhavata/>

¹⁸ Në dispozicion në: https://mvr.gov.mk/vest/11716?fbclid=IwAR22dRPTvDTbXfoYH_G93_j2vY21o4tzoqHkt-1l3qy7-U8A14EZgBFnWKO

Поради моменталната ситуација со вирусот COVID-19, повеќето луѓе треба да останат дома.

За многу жени и деца домот не е безбедно место и претставува зголемен ризик од интимно- партнерско и семејно насилство.

Сите имаме обврска да пријавиме доколку имаме сознание дека се случува насилство во нашето опкружување!

Доколку ти и/или твоите деца сте жртви или сте под ризик од семејно насилство побарај помош на овие броеви:

Скопје

Меѓуопштински центар за Социјална работа:

Специјализиран тим за постапување по итни предмети од ранливи категории
076/381-762 и 078/230-943 (работи 24/7)

Служба за брак и семејство и заштита од семејно насилство - **075/295-118**

Полиција **192**

e masave urgjente për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve-viktima të dhunës në familje gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme¹⁹ me propozim-masa, miratimi i të cilave do të mundësonte mbrojtje të duhur viktimave të dhunës, në përputhje me kushtet e reja të krijuara. Në Kërkesë, në mënyrë konkrete ishin dhënë rreziqet që janë specifike për dhunën në familje dhe përmbante propozim-masa urgjente për trajtim të dhunës në familje, si dhe përgatitje të sistemit të mbrojtjes për veprime në rastet e dhunës në familje pas përfundimit të pandemisë.

Gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme në vendin tonë, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut kishte regjistruar gjithsej pesë denoncime për dhunë në familje, që dëshmon se nuk ekziston tendencë rritjeje të rasteve. Sipas statistikave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në vendin tonë nuk ka rritje të numrit të rasteve të dhunës në familje, krahasuar me periudhën e njëjtë vitin e kaluar. Në nivel javor, rritja e vetme ishte vërejtur vetëm në javën e parë të muajit prill, kurse gjatë javëve të tjera rastet e dhunës në familje kishin qenë në stagnacion.²⁰ Krahasuar me shumë vende të Evropës, por edhe në nivel botëror, ku rritja e dhunës në familje që nga fillimi i izolimit arriti mbi 25%,²¹ kemi arsye të besojmë se të dhënat e konfirmojnë problemin shumëvjeçar të mosdenoncimit nga ana e viktimave, por edhe problemin e mënyrës joadekuate të regjistrimit të veprave penale dhe mbarëvajtjes së statistikës së zbërthyer sipas gjinisë. Arsye tjetër për këtë numër është edhe mënyra joadekuate e kualifikimit të rasteve të dhunës në familje të cilat shumë shpesh trajtohen si kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike, në vend se të trajtohen si vepra penale. Në këtë drejtim flasin edhe informacionet nga Ministria e Punëve të Brendshme, sipas së cilës një pjesë e viktimave që kanë denoncuar në polici, më pas e kanë tërhequr denoncimin dhe për këtë shkak është regjistruar ulje e numrit të veprave penale dhe kundërvajtjeve për dhunë në familje gjatë kësaj periudhe.²²

Në rastet kur dhuna në familje ngel e padenoncuar ose kur institucionet përgjegjëse nuk ia ofrojnë mbrojtjen e duhur viktimës, rritet edhe probabiliteti që dhuna të përshkallëzohet në femicid. Femicid-i, respektivisht vrasja e gruas vetëm pse është grua si formë më e rëndë e dhunës ndaj gruas, është njëra ndër arsyet kryesore për vdekje të hershme të grave në nivel botëror. Sipas hulumtimeve në vendin tonë,²³ në më shumë se 80% të rasteve të vrasjeve, janë kryer në shtëpinë e përbashkët ose nëse është inicuar procedura e divorcit, në shtëpinë e prindërve të viktimës, kurse në numrin më të madh të rasteve vrasja është kryer nga ana e ish-partnerit ose partnerit aktual. Në periudhën e kaluar, në media u komunikua për dy vrasje të grave nga ana e partnerit intim, në Haraçinë²⁴ dhe në Shkup²⁵. Duke marrë parasysh se në vendin tonë femicidi nuk njihet si vepër e posaçme penale në Kodin penal dhe kualifikohet si formë më e rëndë e vrasjes, kur është kryer gjatë aktit të dhunës në familje, mbetet problematike mungesa e të dhënave statistikore për feminicidet, për të cilat burim më i zakonshëm i të dhënave statistikore jozyrtare janë njoftimet si dhe në këtë rast, të dhënat nga mediat.

19 Në dispozicion në:<http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2020/04/Itni-merki-za-zashtita-na-zhenite-i-detsata-zhrtv-na-semejno-nasilstvo-vo-kriza.pdf>

20 Në dispozicion në:<https://bit.ly/2GQbYLE>

21 Në dispozicion në:<https://bit.ly/3hsr06Y>.

22 Në dispozicion në:<https://bit.ly/2RICD56>.

23 Në dispozicion në:http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2013/11/Femicidi-mk.final_.pdf

24 Në dispozicion në:<https://360stepeni.mk/ubistvo-vo-arachinovo-edno-litse-privedeno/>

25 Në dispozicion në: <https://bit.ly/2RqqcVy>.

Me ratifikimin e Konventës së Stambollit, Republika e Maqedonisë së Veriut merr detyrimin për kriminalizimin e çdo akti të qëllimshëm të dhunës në familje ndaj personit tjetër, pavarësisht kontekstit në të cilin kryhet; kurse termi „dhunë fizike“ i referohet lëndimeve trupore si rezultat i forcës së drejtpërdrejtë dhe të paligjshme, përfshi edhe dhunën që rezulton me vdekjen e viktimës. Vendi ynë e merr detyrimin që ta harmonizojë legjislacionin tonë me atë të Konventës, prandaj iu qas përgatitjes së Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje, për përgatitjen e të cilit kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Komitetit të Helsinkit. Ky Ligj ishte parashikuar të miratohet deri kah fundi i vitit 2019, mirëpo për shkak të shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare nuk u vendos në rend dite për votim në Kuvend dhe kriza e shkaktuar nga pandemia edhe më shumë e vonoi miratimin e tij.

Në këtë periudhë me rëndësi të veçantë ishte gjetja e zgjidhjeve të reja dhe kreative për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave, me qëllim që të parandalohet dhuna dhe pasojat e saj fatale. Duke i marrë në konsideratë mundësitë e kufizuara për denoncimin e dhunës në familje në kushtet kur kohën më të madhe partneri gjendet në shtëpi dhe lëvizja jashtë shtëpisë është në minimum, numri më i madh i shteteve aplikuan mënyra alternative të denoncimit të dhunës në familje, duke i përdorur veglat tashmë ekzistuese si mediat sociale, mesazhet me SMS, Whatsapp, por edhe zhvillimi i aplikacioneve të reja falas, dërgimi i mesazheve për përcaktimin e vendndodhjes së viktimës me GPS si dhe përdorimi i shifrave të fshehta në rastet e vizitave në barnatore dhe dyqane.²⁶

Me fillimin e periudhës së izolimit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale paralajmëroi mbi rrezikun në rritje të dhunës në familje përmes shpërndarjes së kontakteve nga serviset për denoncimin dhe mbështetjen e viktimave, kështu që në muajin maj filloi edhe fushata për denoncimin e dhunës në familje gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.²⁷ Megjithatë, përkundër propozim-masave të dorëzuara, përveç masës për denoncim të pandërprerë gjatë kohëzgjatjes së orës policore, shteti nuk arriti të zbatojë asnjë zgjidhje kreative për parandalimin e dhunës, as edhe për lehtësimin e procedurës së denoncimit.

Për më tepër, më 9 prill, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi një vendim²⁸ për të rialokuar 5 milion denarë nga programi për barazi gjinore i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, destinuar për mbështetjen e sektorit civil, i cili është nxitësi kryesor në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna në familje. Duke pasur parasysh se në këtë periudhë është jashtëzakonisht e rëndësishme të mbështesim aktivitetet për zvogëlimin e pasojave negative të krizës mbi të drejtat themelore të grave, lëvizjet e tilla tregojnë se barazia gjinore nuk është një prioritet i sistemit shtetëror.²⁹

26 Në dispozicion në <https://bit.ly/3Zwla5X>.

27 Në dispozicion në <https://bit.ly/3huv5sC>.

28 Vendim për rishpërndarjen e fondeve midis shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe fondeve (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.97/2020 i datës 9 prill 2020)

29 Në dispozicion në <https://bit.ly/3k3ggXz>.

GRUPET E RREZIKUARA

Personat me rrezik social

Të dhënat e fundit të Entit Shtetëror të Statistikës për vitin 2018, tregojnë se madje 21,9% e popullatës në vendin tonë jeton në varfëri,³⁰ kurse Kombet e Bashkuara publikuan një Raport³¹ ku thuhej se këtë vit, kriza me virusin korona mund të sjellë 34 milion njerëz në botë në varfëri të skajshme. Në tentimet për të minimizuar dëmet dhe për të ndihmuar ata që janë në rrezik, qeveritë në të gjithë botën janë përballur me një sfidë të dyfishtë: trajtimin e epidemisë, por gjithashtu marrjen e masave të duhura për të mbrojtur qytetarët më të rrezikuar. Organizata Ndërkombëtare e Punës në periudhën nga 1 shkurt deri më 17 prill regjistroi 548 masa të miratuara për mbrojtje sociale në 108 shtete.³²

Në vendin tonë, largimet masive nga puna, ulja ose mospagimi i paarsyeshëm i pagave të mijëra punëtorëve ku numër i madh familjesh mbetën me ulje drastike ose pa asnjë të ardhur, në këtë kohë krize vetëm do t'i shtojë pabarazitë ekszistuese. Qeveria e RMV-së publikoi se për muajt prill dhe maj të vitit 2020 mundësohet futje e shpejtë në sitemin e mbrojtjes sociale e familjeve që kanë mbetur pa të ardhura. Njëherit, këto persona mund ta shfrytëzonin ndihmën e garantuar minimale pas vlerësimit të mesatares së të ardhurave të tyre të përgjithshme për muajin e fundit, dhe jo për tre muajt e fundit siç parashikon Ligji për mbrojtje sociale. Qeveria miratoi Dekret me të cilin 30.000 përdorues të ndihmës sociale përfituan një shumë shtesë prej 1.000 denarë për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të energjisë në familje, për muajt prill dhe maj të vitit 2020.³³ Përdoruesit e ndihmës sociale përfitojnë kompensim monetar shtesë për energji për periudhën nga tetori e deri në muajin mars,³⁴ prandaj kjo masë nënkuptonte vazhdimin e pagesës së këtij kompensimi për edhe dy muaj shtesë.

Gjithashtu, kushti për konfirmimin e rregullsisë për pagesën e kompensimit për arsim për periudhën e tretë dhe të katërt matëse për vitin shkollor 2019/2020 ka pushuar së zbatuari. Pagesa e kompensimit për arsim vazhdoi, në shumë prej 700 denarë për fëmijë në arsimin fillor dhe 1.000 denarë për fëmijë në

30 Enti Shtetëror i Statistikës, „Indikatorë laekenë mbi varfërinë në vitin 2018 – të dhëna definitive“, në dispozicion në <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSooopstenie.aspx?rbrtxt=115>.

31 Kombet e Bashkuara, „COVID-19 do ta zvogëlojë prodhimtarinë ekonomike në botë për 8,5 trilion dollarë për tre vitet e ardhshme“, në dispozicion në <https://www.un.org/development/desa/en/news/policy/wesp-mid-2020-report.html>.

32 Organizata Ndërkombëtare e Punës, „Përgjigje ndaj krizës me COVID -19 në fushën e mbrojtjes sociale: Përgjigjet e shteteve dhe mendimet për politikën“, në dispozicion në <https://www.social-protection.org/gimi/RessourcePDF.action?id=56044>.

33 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Dekreti me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për mbrojtje sociale në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 89/2020).

34 Neni 42 i Ligjit për mbrojtje sociale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ n.104/2019).

arsimin e mesëm, dhe kjo nënkuptonte se rreth 17.000 fëmijë vazhduan të marrin kompensimin monetar për arsim.³⁵

Shteti i harmonizoi procedurat administrative për përfituesit ekzistues të të drejtave nga mbrojtja sociale dhe, ndër të tjera, zgjati afatin për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm, kryerjen e ekzaminimeve shëndetësore dhe inspektimin e shtëpive të përfituesve. Megjithatë këto masa kishin për qëllim të lehtësonin ushtrimin e të drejtave nga mbrojtja sociale të qytetarëve në rrezik social, disa nga personat që kërkuar ndihmë juridike nga Komiteti na informuan se ndërsa përpiqeshin ta bënin këtë, ata hasën në disa probleme dhe mospërputhje.

Rekomandimet e qytetarëve për të qëndruar në shtëpi nënkuptonin lëvizje të kufizuara, e cila gjithashtu ndikoi në aksesin e tyre në institucione. Shumë nga ata qytetarë që dëshironin të respektonin masat qeveritare dhe të mbronin shëndetin publik u përpoqën të kontaktojnë me telefon qendrat e punës sociale, por në pjesën më të madhe, ato nuk ishin në dispozicion. Disa prej tyre vendosën të shkojnë personalisht në qendra, por në të njëjtën kohë u ndeshën me zyrtarë që nuk i ndihmuan aspak në ushtrimin e të drejtave të tyre.

Familjet e varfra që jetojnë në kushte jashtë standardeve janë në rrezik më të lartë nga përhapja e virusit korona, kjo për shkak të të ardhurave të ulëta ose situatës pa asnjë të ardhur për furnizimin e preparateve për higjienë personale dhe për dezinfektim. Një pjesë e tyre nuk kanë as qasje në ujë. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale kishte **shpërndarë pako higjienike për 400 familje** që jetojnë në kushte të tilla edhe atë në qytetet Probishtip, Tetovë, Shkup, Resnje, Vinicë, Sveti Nikollë, Krushevë, Strugë, Gostivar, Kriva Pallankë, Vallandovë dhe Kumanovë. Ndër kategoritë e qytetarëve të rrezikuar janë edhe familjet me një prind, përfitues të ndihmës së garantuar minimale, ku numri më i madh janë gra (95 %), viktimat të dhunës në familje, si dhe viktimat që janë të akomoduar në qendrat e përkujdesjes. Ministria në bashkëpunim me UN Women **siguroi 1.860 pako me ushqim dhe produkte higjienike** për këtë kategori qytetarësh.

Paketa e tretë e masave ekonomike, të cilën e miratoi Qeveria për ndihmën e të varfërve, të rinjve dhe familjeve me të ardhura të ulëta, parashikon sigurimin e kartave të pagesës në shumë prej 9.000 denarë për 100.000 qytetarë, me qëllim që të blihen produkte dhe shërbime vendore. Kjo masë është në dispozicion për të gjithë personat e papunë, kërkuar të punës që nuk kanë mbi 15.000 denarë të ardhura mujore, si dhe për përfituesit e ndihmës së garantuar minimale. Këto grupe qytetarësh, nga shteti përfituan edhe kuponë në shumë prej 6.000 denarë, të destinuara për turizëm. Komiteti i Helsinkit së bashku me disa sindikata dhe organizata të shoqërisë civile **reaguan** se masat e propozuara nuk duhet të bëjnë dallim midis të punësuarve dhe personave të papunë. Shumë personave të punësuar nuk ua kanë paguar pagat gjatë kohës së krizës, ose u kanë paguar paga më të ulëta, kështu që edhe pse ishin ligjërisht të punësuar, kjo nuk kishte asnjë rëndësi për ta. Ishte propozuar që të drejtën për kompensim të njëfishtë prej 9.000

³⁵ Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, „Shteti kujdeset për personat që kanë qenë pjesë e ekonomisë joformale dhe që kanë mbetur pa të ardhura – siguron ndihmë monetare për familjet dhe shtesë energjetike për përfituesit e mbrojtjes sociale“, në dispozicion në

http://mtsp.gov.mk/covid-19-ns_article-drzavata-se-grizi-za-licata-koi-bile-del-od-neformalnata-ekonomija-i-ostanale-bez-prihodi-obezbeduva.nspix.

denarësh ta përfitojnë qytetarët të cilët gjatë tre muajve të fundit, mesatarisht kanë pasur të ardhura më të ulëta se 15.000 denarë në muaj. Për më tepër, përdorimi i kësaj kartë pagese duhej të ishte pa kufizime për një periudhë aq të shkurtër, respektivisht të vlejë edhe pasi qytetarët të mos e kenë shfrytëzuar këtë ndihmë sociale dhe t'u lejojë hapësirë për të planifikuar konsumin, varësisht nga nevojat e tyre reale. Si rezultat i kësaj, Komiteti i Helsinkit konsideroi se mënyra më e përshtatshme do të ishte ndihma e drejtpërdrejtë financiare nga ana e shtetit për qytetarët dhe qytetaret e prekura.

Mbrojtja e fëmijëve – kontaktimi me prindin

Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve me shqetësim **vëri në dukje** se në vendet që kanë shpallur gjendje të jashtëzakonshme dhe karantinë të detyrueshme si rezultat i pasojave të pandemisë, shumë fëmijë (sidomos ato më të prekurit) në mënyrë serioze janë prekur fizikisht, emocionalisht dhe psikologjikisht. Në vendin tonë, një aspekt i rëndësishëm i situatës së krizës, të cilës nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme është realizimi i vështirë i të drejtës së fëmijës për të mbajtur kontakte personale me prindin me të cilin nuk jeton. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale **vëri në dukje se** në kushte pandemie kur është vënë në pyetje shëndeti dhe jeta e njerëzve, prindërit kanë obligim që të kujdesen për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve dhe të përshtatin lëvizjen e fëmijëve në përputhje me rekomandimet e Qeverisë për veprim në kushte të gjendjes së jashtëzakonshme dhe orës së vendosur policore. Në këto kushte, Ministria bëri thirrje për një marrëveshje të ndërsjellë midis prindërve për mënyrën e mbajtjes së kontaktit të fëmijëve me prindin me të cilin nuk jetojnë, ndërsa në anën tjetër fëmijët të mos jenë të ekspozuar ndaj rreziqeve të pandemisë. Për më tepër, ata informuan se qendrat për punë sociale si institucione kompetente janë të hapura dhe janë në dispozicion të prindërve për të ofruar mbështetjen e nevojshme profesionale dhe këshilluese që të bien dakord mbi mënyrën se si të mbahen marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve.

Rastet në të cilat qendrat për punë sociale kanë vendosur për mbajtjen e kontakteve personale me prindin me të cilin fëmija nuk jeton, janë ato raste ku prindërit nuk kanë arritur një marrëveshje të ndërsjellë mes tyre. Prandaj, në një farë mase, është i pabazuar ky rekomandim i Ministrisë, i cili udhëzon prindërit të arrijnë marrëveshje të ndërsjellë për mënyrën e takimeve me njëri-tjetrin. Për disa nga prindërit që iu drejtuan Komitetit të Helsinkit, kjo ishte edhe një sfidë shtesë. Për shkak të pamundësisë për të arritur një marrëveshje të përbashkët dhe për shkak të mungesës së shërbimeve të një pjese të qendrave për punë sociale (edhe përkundër angazhimit të Ministrisë për hapje dhe ofrim ndihme), një pjesë e fëmijëve për një periudhë të gjatë nuk kishin kontaktuar me njërin prind. Në këtë mënyrë, institucionet kompetente dështuan në detyrimin e tyre që gjithmonë ta kenë parasysh mbrojtjen e interesit më të mirë për fëmijën.

Personat e pastrehë

Federata Evropiane e Organizatave Kombëtare që punojnë me personat e pastrehë e ka theksuar faktin se personat e pastrehë janë kategori veçanërisht e prekur në kontekstin e pandemisë së shkaktuar nga KOVID-19. Ato paralajmëruan se qëndrimi në vendstrehim të përkohshëm ose urgjent (bujtina, strehimore nate etj.) i vë nën rrezik të madh nga infektimi me virus dhe rrezikon qasjen e tyre në vende për mirëmbajtjen e higjienës personale. Përpos kësaj, personat e pastrehë po përballen me pengesa jashtëzakonisht më serioze në qasjen për mbrojtje shëndetësore, përfshi këtu edhe qasjen në testime për prezencën e virusit, si dhe në përgjithësi qasjen të informacionet për mbrojtjen e shëndetit publik. Në rastet e infektimit me KOVID-19, transmetimi i virusit të kjo kategori njerëzish është vështirë e kontrollueshme, që do të thotë se mbrojtja e personave të pastrehë është element i rëndësishëm në luftimin e krizës së madhe shëndetësore. Shumica e masave të dedikuara për popullatën në përgjithësi - vetizolimi, qëndrimi në shtëpi, përmirësimi i higjienës personale, respektimi i distancës sociale dhe fizike – nuk janë zgjidhje reale për personat e pastrehë.³⁶

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale informoi se pikat e strehimit në Shkup, Manastir, Strumicë dhe Strugë, të hapura në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, janë funksionale dhe në përputhje me rekomandimet e Qeverisë dhe shpërndajnë ushqime të paketuara, maska dhe xhel për dezinfektim për personat e pastrehë. Ministria njoftoi se në Shkup funksionon edhe qendra mjekësore në Momin Potok, në organizimin e Kryqit të Kuq dhe se produktet higjienike u janë shpërndarë edhe familjeve të pastrehë, të akomoduar në Vizbeg. Megjithatë, institucionet kompetente nuk e informuan plotësisht opinionin mbi trajtimin e problemeve me të cilët përballen personat e pastrehë. Mungoi informimi rreth ofrimit të kushteve përkatëse ku personat e pastrehë do të mund të kujdeseshin për higjienën e tyre personale. Institucionet fare nuk njoftuan për aksionet e ndërmarra për informimin e personave të pastrehë për pandeminë dhe pasojat e saj negative, si dhe informimin për mënyrën se si mund ta mbrojnë shëndetin e tyre publik.

Nëse nuk merren në konsideratë kushtet specifike ku gjenden personat e pastrehë dhe nuk merren masa të nevojshme që drejtpërdrejt do të synojnë mbrojtjen e tyre, kjo kategori e rrezikuar e qytetarëve do të lihet jashtë përgjigjeve të politikave publike për përballjen me pandeminë.

Personat në moshë

Rrezikun që e sjell infektimi me virus, për personat në moshë, veçanërisht për personat me gjendje të paqëndrueshme shëndetësore është shumë i madh dhe shumë lehtë mund të vie deri te zhvillimi i sëmundjes dhe deri te vdekja.³⁷ Për rrezikun e lartë të vdekshmërisë shkaktuar nga virusi të personat në moshë flasin edhe statistikat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, sipas së cilave vdekshmëria nga virusi të personat

³⁶ Federata Evropiane e Organizatave Kombëtare që punojnë me persona të pastrehë, „KOVID-19: Qëndrimi në shtëpi nuk është opsion për personat e pastrehë“, në dispozicion në <<https://www.feantsa.org/en/news/2020/03/18/covid19-staying-home-not-an-option-for-people-experiencing-homelessness?bcParent=26>>.

³⁷ Agjencia për të Drejtat Themelore (FRA), „Pandemia e shkaktuar nga virusi korona në BE – Implikimet për të drejtat themelore“, në dispozicion në <https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2020-coronavirus-pandemic-eu-bulletin_en.pdf>.

në moshë mbi 80 vjeç është për pesë herë më e madhe se mesatarja „normale”.³⁸

Në vendin tonë, personat në moshë, veçanërisht personat mbi 67 vjeç ishin një ndër qytetarët më të prekur nga rreziqet shëndetësore që i solli pandemia, por edhe nga masat kufizuese për parandalim. Masat për kufizimin e lëvizjes që u miratuan nga ana e Qeverisë së RMV-së, të cilat për këtë grup qytetarësh ishin më të rrepta që nga fillimi, dhe qëllimi i të cilave ishte parandalimi dhe mbrojtja si persona më të rrezikuara, u treguan të papërshtatshme për personat në moshë. E gjithë kjo, kryesisht për shkak të kohës së shkurtër të parashikuar për kryerjen e obligimeve, e cila vetëm kontribuoi në një përqendrim më të madh të më shumë njerëzve në vendet me interes, por edhe për shkak të izolimit social shtesë të personave në moshë, në veçanti për personat që jetojnë të vetëm. Duke marrë parasysh se një pjesë e konsiderueshme e personave në moshë varen nga mbështetja e personave të tjerë për kryerjen e obligimeve dhe plotësimin e nevojave të caktuara, rekomandimet e dhëna për respektimin e distancës sociale imponuan një ndërlirim të ndjeshëm sa i përket funksionimit të tyre të përditshëm. Si rezultat i pamundësisë për t'i respektuar plotësisht rekomandimet për mbrojtje, u paraqit edhe një prezencë në rritje e gjuhës së urrejtjes në mediat sociale, ku u publikuan fotografi të personave në moshë që prisnin rradhë para bankave dhe dyqaneve, pa i respektuar paraprakisht rekomandimet për distancën e parashikuar fizike.

Me Vendimin e Qeverisë të datës 23 mars 2020 u ndalua lëvizja e personave mbi 67 vjeç, për periudhën kohore prej orës 11:00 deri në orën 5:00 të ditës së ardhshme.³⁹ Pas disa ndryshimeve, me rregullin e fundit të vlefshëm u ndalua lëvizja e këtyre personave nga e hëna deri të premtën për periudhën prej orës 12:00 deri në orën 5:00 të ditës së ardhshme dhe nga ora 11:00 të shtunën e deri në ora 5:00 të hënën.⁴⁰ Më 14 maj, Gjykata Kushtetuese ngriti procedurë për vlerësimin e kushtetueshmërisë së këtij Vendimi dhe ndërpreu çfarëdo veprimi bazuar në atë Vendim, me çrast lejoi që personat më të moshuar se 67 vjeç të lëvizin sikur personat e tjerë – nga ora 5:00 në mëngjes e deri në ora 19:00 pasdite. Arsyeimi i Gjykatës Kushtetuese, siç raportuan mediat, është se shumica e gjykatësve konsideruan se masa është diskriminuese për të dy kategoritë e qytetarëve,⁴¹ si dhe të rishikohet përsëri kushtetueshmëria e këtij Vendimi.

Që nga fillimi i pandemisë ishin aktive ekipet e lëvizshme të Kryqit të Kuq, fillimisht në territorin e Shkupit dhe më vonë në tërë territorin e vendit, siguronin mbështetje të përditshme grupeve të rrezikuara të popullsisë, përfshi edhe personat në moshë. Mbështetja e ekipeve të lëvizshme përbëhet prej kryerjes së furnizimeve të domosdoshme të barnave, produkteve ushqimore dhe preparateve për higjienë personale, të cilat më pas i dërgojnë nëpër shtëpitë e qytetarëve. Mbi të gjitha, shërbimi i ekipeve të lëvizshme është falas, kurse qytetarët i paguajnë vetëm artikujt që i porositin. Për më tepër, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale siguroi përkrahje në shtëpinë për personat e moshuar, me synim lehtësimin e funksionimit të përditshëm, si dhe asistencë për realizimin e procedurave urgjente administrative, furnizime dhe lloje tjera mbështetjesh, me të cilat ishte mbuluar një e treta e komunave të vendit tonë.

38 Kombet e Bashkuara, „Ndikimi i KOVID -19 te personat në moshë “, në dispozicion në

<https://unsdg.un.org/sites/default/files/2020-05/Policy-Brief-The-Impact-of-COVID-19-on-Older-Persons.pdf>.

39 Vendim për ndryshimin e Vendimit për ndalim dhe regjim të veçantë të lëvizjes në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 6p.74/2020).

40 Vendim për ndryshimin e Vendimit për ndalim dhe regjim të veçantë të lëvizjes në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 6p.107/2020).

41 Regjimi i veçantë i lëvizjes përpos personat mbi 67 vjeç i përfshiu edhe personat nën 18 vjeç.

PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Rrezikshmëri e shumëfishtë

Pasojat joproporcionale të pandemisë ndaj grupeve të caktuara qytetarësh ishin ndjeshëm të dukshme te personat me aftësi të kufizuara, si një ndër grupet më të marginalizuara në shoqëri. Edhe përkundër faktit që aftësitë e kufizuara vetvetiu nuk nënkuptojnë se një person është në rrezik më të madh nga infektimi me virus, pjesa më e madhe e personave me aftësi të kufizuara kanë një gjendje më të ndjeshme shëndetësore, të cilët i vë në rrezik më të madh nga vetë sëmundja.

Me fillimin e pandemisë, Organizata Botërore e Shëndetësisë paralajmëroi për rrezikun e shtuar te personat me aftësi të kufizuara nga infektimi me virusin, që para së gjithash është rezultat i barrierave ekzistuese për zbatimin e masave themelore për mbajtjen e higjienës, vështirësive në praktikimin e distancimit social për shkak të nevojës për mbështetje shtesë ose banim në institucion, nevojës për prekje si mënyrë e marrjes së informacionit nga rrethina, problemeve paraprake shëndetësore dhe të ngjashme.⁴²

Sipas analizës së realizuar nga ana e Qendrës për Hulumtim dhe Krijim Politikash,⁴³ masat e parandalimit nga virusi që po zbatohen në vendin tonë nuk janë përshtatur për një pjesë të personave me aftësi të kufizuara, sidomos për

personat që përdorin vegla ndihmëse (karrocë me rrota, këpucë ortopedikë etj.) në sipërfaqen e të cilave virusi mund të qëndrojë për kohë të gjatë. Nëse e kemi parasysh se këto persona zakonisht posedojnë vetëm një vegël ndihmëse që e përdorin për lëvizje si jashtë ashtu edhe brenda shtëpisë, ekziston rrezik i madh nga transmetimi i virusit edhe te personat e tjerë me të cilët e ndajnë shtëpinë.

Personat me aftësi të kufizuara në përgjithësi kanë më shumë nevoja shëndetësore se personat e tjerë, pavarësisht nëse bëhet fjalë për nevoja të përditshme ose nevoja lidhur me pengesat, kështu që i bën më të ndjeshëm në rastet e mungesës dhe/ose kufizimit të shërbimeve shëndetësore. Qysh nga fillimi i pandemisë në Evropë, Forumi Evropian i Aftësive të Kufizuara⁴⁴ e kishte alarmuar Bashkimin Evropian mbi rreziqet me të cilët po përballen personat me aftësi të kufizuara, të shkaktuara nga mungesa e mbështetjes dhe shërbimeve të nevojshme, përkeqësimit paraprak të gjendjes shëndetësore te pjesa më e madhe e personave me aftësi të kufizuara që paraqet bazë për zhvillimin e sëmundjes dhe vdekjen, si dhe përjashtimit nga informacionet lidhur me shëndetin.⁴⁵

Nëse e marrim parasysh se edhe në kushte „normale“ personat me aftësi të kufizuara kanë qasje të vështirësuar në shërbimet shëndetësore, arsim, punësim, mjete informimi etj., në kushte krize shëndetësore, aksesit në disa të drejta të caktuara për këto persona mund të pamundësohet në mënyrë të konsiderueshme. Kështu për shembull, personat me aftësi të kufizuara që janë përballur me vështirësi për të hyrë në tregun e punës para pandemisë, tani janë në rrezik edhe më të madh nga humbja e vendit të punës, por edhe vështirësi për t'u kthyer në punë. Njëherit vlerësohet se rekomandimi që të punohet nga shtëpia, në vendin tonë mund ta kryejnë me 1 % të personave me aftësi të

42 Në dispozicion <https://bit.ly/3hoMq4R>.

43 Në dispozicion <https://bit.ly/2FzL4at>

44 European Disability Forum (EDF).

45 Në dispozicion <https://bit.ly/3mjzaCp>.

kufizuara, të punësuar në ndërmarrjet mbështetëse.⁴⁶

Veçanërisht e palakmueshme është situata e personave me aftësi të kufizuara të cilët kanë një gjendje paraprakisht të dobët shëndetësore dhe/ose që jetojnë në një institucion, i cili është një tregues i dobësive të sistemit të shërbimeve publike dhe aksesit të pabarabartë në to për disa kategori të rrezikuara.⁴⁷ Personat me aftësi të kufizuara që janë akomoduar në institucione rezidenciale shpesh janë në kontakt të afërt me shumë njerëz, shpesh jetojnë në kushte të pakënaqshme sanitare dhe parandalimi dhe mbrojtja e tyre plotësisht varet nga personat e kujdesit, respektivisht personat përgjegjës të institucioneve.⁴⁸

Për shkak të komunikimit të rënduar dhe izolimit në shtëpi, rreziku nga dhuna në familje është rritur ndjeshëm në periudhën e krizës së këtij lloji, dhe njëherit janë kufizuar mundësitë dhe resurset në dispozicion për denoncim. Raportet paraprake për ndikimin e pandemisë mbi disa grupe të rrezikuara në shoqëri kanë treguar se masat kufizuese kanë rritur thelbësisht dhunën në familje në nivel botëror, duke pasur parasysh që fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara janë në rrezik më të madh nga dhuna sesa bashkëmoshatarët e tyre pa aftësi të kufizuara, e në veçanti i prek gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.⁴⁹

Lëvizja e lirë

Te personat me aftësi të kufizuara, sidomos te personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe te personat me çrregullime të spektrit autistik, segment shumë i rëndësishëm i funksionimit paraqet rutina e përditshme. Në kushte kur lëvizja është kufizuar në kohë, por edhe fizikisht, vjen deri te ndryshimi i rutinës që te shumë persona me aftësi të kufizuara mund të shkaktojë ankth; dhe si rezultat, ata persona që kujdesen për fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara u përballën me sfidën e gjetjes së mënyrave alternative të funksionimit të përditshëm dhe krijimit të rutinave të reja. Mbyllja e qendrave ditore imponoi një sfidë plotësuese për personat me aftësi të kufizuara që kanë vizituar rregullisht qendrat ditore si pjesë e funksionimit të përditshëm, por edhe për personat që kujdesen për ta, duke marrë parasysh se duhet të qëndrojnë në shtëpi, madje zakonisht edhe duke humbur vendin e tyre të punës.

Duke marrë në konsideratë se për një pjesë të madhe të personave me aftësi të kufizuara lëvizja paraqet aktivitet terapeutik dhe pjesë e shprehisë së përvetësuar, Qeveria e RMV-së miratoi dekret me të cilin ishte parashikuar regjim i veçantë i lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara gjatë kohëzgjatjes së orës policore.⁵⁰ Personat me aftësi të kufizuara mund të dilnin me një shoqërues në kohën e caktuar për lëvizje, për të cilën nuk ishin të detyruar të nxjerrin leje të posaçme për lëvizje, por të kenë me vete dokumentin me të cilin e dëshmojnë aftësinë e kufizuar.⁵¹

46 Në dispozicion në <https://bit.ly/2ZxLRzS>

47 Në dispozicion në <https://bit.ly/33xd4E2>.

48 Në dispozicion në <https://bit.ly/2Zzc5BX>.

49 Në dispozicion në https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/sg_policy_brief_on_persons_with_disabilities_final.pdf.

50 Në dispozicion në: <https://vlada.mk/node/20925>

51 Në dispozicion në <https://bit.ly/2FxeG8f>.

Ndihmë dhe mbështetje

Masat kufizuese që fillimisht përbëheshin nga rekomandimet për vetizolim dhe distancim social, për numër të madh personash me aftësi të kufizuara ishte jashtëzakonisht vështirë të zbatohen, sidomos kur kihet parasysh se një pjesë e madhe e tyre varen nga asistenca e personave të tjerë, ndonjëherë edhe për kryerjen e nevojave elementare fiziologjike.

Në lidhje me masat për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, vetëm 27 komuna të vendit u përfshin me masën e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale për mbështetje në shtëpi.⁵² Kjo masë kishte synim lehtësimin e funksionimit të përditshëm të personave me aftësi të kufizuara, përfshi edhe asistencën për kryerjen e procedurave urgjente administrative, furnizime dhe lloje tjera mbështetjesh sipas nevojave të personit.

Njërrethanë lehtësuese ishte vendimi i Qeverisë për të zvogëluar procedurat administrative në lidhje me përdorimin e të drejtave të caktuara nga mbrojtja sociale, ku përfituesit nuk ishin të detyruar të ripërtrijnë dokumentacionin e nevojshëm nëse dëshirojnë të vazhdojnë të përdorin përfitime të caktuara, kurse për përdorimin e shërbimeve të caktuara, dokumentacionin mund ta dorëzonin edhe në mënyrë elektronike.

Arsimi (Jo)inkluziv

Në bazë të të dhënave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ekzistojnë indicie se kriza e tanishme do të ndikojë seriozisht në rritjen e përjashtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara nga procesi arsimor. Vlerësohet se fëmijët me aftësi të kufizuara do të kenë më së paku përfitime nga aplikimi i zgjidhjeve alternative për mësim nga distanca, të cilës i bashkangjitet mungesa e mbështetjes në shtëpi, mungesa e aksesit në internet, mungesa e softuerit të përshtatshëm dhe materialeve mësimore.⁵³ Duke i pasur parasysh të gjitha këta pengesa, ka rrezik të madh nga ndërprerja e plotë e arsimit të fëmijët me aftësi të kufizuara gjatë kësaj periudhe, që në mënyrë shtesë do ta vështirësonte kthimin e tyre në procesin arsimor pas përfundimit të situatës së krizës. Në afat të gjatë, ky hendek në procesin arsimor edhe më shumë do të kontribuojë edhe në thellimin e hendekut në lidhje me pjesëmarrjen në tregun e punës, që për personat me aftësi të kufizuara ky hendek është jashtëzakonisht i madh.

52 Në dispozicion në: http://mtsp.gov.mk/pocetna-ns_article-licata-so-poprecenost-i-starite-lica-vo-27-opshtini-kje-dobijat-asistencija-za-polesno-spravuvanje-s.nspix

53 Në dispozicion në: https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/sg_policy_brief_on_persons_with_disabilities_final.pdf

Në vendin tonë, fëmijët me nevoja të posaçme arsimore, sidomos fëmijët me aftësi të kufizuara, që nga fillimi i pandemisë u përballën me sfida të shumta. Platformat online për mësim nga distanca që e zëvendësuan arsimin e rregullt, me fillimin e vetizolimit i përjashtuan shumicën e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Arsimi i tyre gjatë kësaj periudhe ishte lënë plotësisht në duart e prindërve të tyre dhe vullnetin e disa asistentëve arsimorë. Pasi kaloi më shumë se një muaj nga mbyllja e shkollave, fare në fund të muajit prill ishte promovuar platforma online për mësim dhe zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, e cila duhej të ofronte mbështetje plotësuese, qasje të individualizuar dhe orë të modifikuara të mësimin, që fëmijët të mund të vazhdonin procesin arsimor edhe në kushte shtëpiake.

Ligji i ri për arsim fillor ishte miratuar në gushtin e vitit 2019 dhe menjëherë në shtator kishte filluar edhe zbatimi i tij, me fillimin e vitit shkollor 2019/2020, sipas të cilit arsimi fillor ishte organizuar në mënyrë institucionale, kadrovike dhe përmbajtësore për të mundësuar përfshirje të të gjithë fëmijëve në arsimin e rregullt. Mirëpo, edhe pse jemi në prag të fillimit të vitit të ri shkollor, dhe ende nuk janë miratuar aktet nënligjore që duhej të ofronin zbatim të duhur të Ligjit dhe përfshirje të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në të gjitha aspektet e procesit arsimor, veçanërisht për të eliminuar mangësitë e shumta për të cilat shumë herë kishte alarmuar Komiteti i Helsinkit që nga vetë fillimi i zbatimit të tij.



PERSONA TË PRIVUAR NGA LIRIA



Burgjet paraqesin mjedise me rrezik të lartë transmetimi të sëmundjeve ngjitëse. Me faktin se vetë përditshmëria në burg në pjesë të madhe përfshin lëvizjen e popullatës së tij në grupe më të vogla ose më të mëdha, edhe atë zakonisht në kushte të këqija higjienike, si dhe qasja vazhdimisht e rënduar për mbrojtje të duhur shëndetësore, i vë personat e privuar nga liria në situatë veçanërisht të ndjeshme gjatë kohës së kësaj pandemie botërore.

Me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe hyrjen në fuqi të masave të veçanta për mbrojtje dhe parandalim nga KOVID-19, institucionet ndëshkuese-korrigjuese e kufizuan, respektivisht i ndaluan vizitat dhe përfitimet e tjera të personave të privuar nga liria. Një veprim i tillë i institucioneve si duket u bë një praktikë e heshtur e shtetit në përgjithësi, prandaj në këtë drejtim Agjencia për të Drejtat Themelore (FRA) në raportin e saj thekson

se „shumica e vendeve-anëtare të Bashkimit Evropian kanë miratuar masa në muajin mars 2020, me të cilat i ndalojnë përkohësisht ose të paktën i kufizojnë vizitat nëpër burgje.“⁵⁴

Në datë 15 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e publikoi dokumentin e saj me titull „**Gatishmëria, parandalimi dhe kontrolli i KOVID-19 në burgje dhe institucione të tjera për persona të privuar nga liria – Udhëzime të përkohshme**“, qëllimi i të cilit është „t’u ndihmohet shteteve që të hartojnë plane të veçanta dhe/ose të krijojnë aktivitete shtesë për burgjet dhe institucionet e tjera për personat e privuar nga liria, si përgjigje ndaj epidemisë ndërkombëtare të KOVID-19“⁵⁵. Kur bëhet fjalë për rishikimin e masave kufizuese për qasjen dhe kufizimin e lëvizjes, theksohet se „ndalimi i përkohshëm i vizitave në burgje do të duhet të rishikohet me kujdes në përputhje me vlerësimet lokale të rrezikut dhe në bashkëpunim me kolegët e shëndetit publik, dhe duhet të përfshijë masa për zbutjen e ndikimit të mundshëm negativ të një mase të tillë mbi popullatën e burgjeve.“⁵⁶

Në lidhje me personat e mitur të privuar nga liria, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës pranë Kombeve të Bashkuara u bëri thirrje vendeve që të kenë parasysh se „ndonëse këto masa kufizuese mund të konsiderohen të nevojshme në afat të shkurtër, megjithatë në periudha të gjata do të kenë pasoja të shprehura negative mbi fëmijët. Fëmijëve në çdo kohë duhet t’ju mundësohet rregullisht mbajtja e kontaktit me familjet e tyre, madje nëse jo personalisht, atëherë përmes komunikimit elektronik ose telefonit. Nëse zgjatet periudha e gjendjes së jashtëzakonshme, duhet të merret në konsideratë një rivlerësim i masave që ndalojnë vizitat.“⁵⁷

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut kërkoi të dhëna se cilat mënyra alternative të komunikimit u janë ofruar personave të privuar nga liria nga institucionet ndëshkuese-korrigjuese në vendin tonë, por deri në çastin e publikimit të këtij raporti, ende nuk ka arritur një përgjigje. Vetëm ENK Burgu Shkup me një përgjigje individuale na njoftoi se vizitat e personave të paraburgosur kryhen individualisht dhe pa kontakt, në hapësira për vizitat e personave të paraburgosur, kurse pas çdo vizite bëhet dezinfektimi i hapësirës. Ndërsa vizitat e personave të dënuar janë të ndaluara, për komunikim me botën e jashtme janë siguruar dy telefonë celularë, të cilët të dënuarit i përdorin sipas nevojës.

Më 8 prill 2020 në ENK Burgu Shkup vdiq një person i paraburgosur dhe pas kryerjes së autopsisë u konstatua se kishte qenë pozitiv në virusin korona. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, në burg janë kryer testime për të gjithë stafin e burgut dhe personat e privuar nga liria dhe rezultatet e të gjitha testeve ishin negative.



54 Fundamental rights agency (FRA), Coronavirus pandemic in the EU- fundamental rights implications - Në dispozicion në:<https://fra.europa.eu/en/publication/2020/covid19-rights-impact-april-1>

55 Ibid.

56 Ibid.

57 Committee on the Rights of the Child (CRC), Statement: The Committee on the Rights of the Child warns of the grave physical, emotional and psychological effect of the COVID-19 pandemic on children and calls on States to protect the rights of children - Në dispozicion në:https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CRC/Shared%20Documents/1_Global/INT_CRC_STA_9095_E.pdf

Burgu Kumanovë

Në Komitetin e Helsinkit arriti një parashtresë nga persona të dënuar që e vuan dënimin me burg në ENK Burgu Kumanovë, në të cilën thuhej se në institucion nuk u sigurohet uji i pijshëm, madje as uji për higjienë personale. Problemi i furnizimit me ujë në ENK Burgu Kumanovë ishte vërejtur edhe me rastin e vizitave të përfaqësuesve të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në burg më 5 prill 2019. Me atë rast, drejtori i institucionit na njoftoi se në bashkëpunim me një ndërmarrje rajonale me përgjegjësi shoqërore, problemi i furnizimit me ujë në burg përkohësisht është zgjidhur, duke bërë një rrjet nënujor. Mirëpo, në bisedë me disa prej të burgosurve thuhej se në burg nuk ka ujë fare dhe në të gjitha dhomat e burgut ishin vërejtur numër i madh i shisheve plastike me ujë. Në të njëjtën kohë ishin vërejtur edhe shishet boshe të lëna në vrimat e tualeteve në hapësirat e qëndrimit, për të parandaluar erën. Më 19.09.2019 ishte kryer një vizitë plotësuese në ENK Burgu Kumanovë, ku përsëri në bisedë me personat e burgosur thuhej se ende nuk ka ujë fare, gjegjësisht personat e burgosur mbushin shishe me ujë nga njësia e paraburgimit të institucionit e cila gjendet në përdhese, pas marrjes së lejes paraprake nga policia e burgut. Sipas udhëzimeve të Komitetit për parandalim të torturës (KPT), për të gjithë institucionet në juridiksionin e të cilëve bien personat e privuar nga liria, në territorin që mbulon Këshilli i Evropës, „marrja e të gjitha masave të mundshme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së personave të privuar nga liria, duhet të jetë parim themelor. Marrja e këtyre masave gjithashtu kontribuon në ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve në këto institucione. Udhëzimet e OBSH-së për mbrojtje nga pandemia, si dhe udhëzimet kombëtare shëndetësore dhe klinike që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duhet të respektohen dhe plotësisht të zbatohen në të gjitha institucionet e mbyllura.“⁵⁸ Komiteti i Helsinkit deri te Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve parashtroi kërkesë për realizimin e një mbikëqyrje të jashtëzakonshme në burg. Me anë të mbikëqyrjes synohet të konstatohet nëse personave të burgosur që janë shtetas të huaj, ua kanë siguruar kushtet e duhura për jetë dhe për mbajtjen e higjienës, duke i marrë parasysh konstatimet e kësaj parashtrese dhe se cilat masa janë ndërmarrë nga ana e institucionit në kushtet e problemeve të furnizimit me ujë për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së të burgosurve, paraburgosurve dhe të punësuarve në ENK Burgu Kumanovë.

Në bashkëpunim me Shoqatën Maqedonase të Juristëve të Rinj, deri te institucionet kompetente ishin parashtruar **rekomandime të përbashkëta** për marrjen e masave të intensifikuara për mbrojtjen e personave të privuar nga liria në kushte pandemie me virusin COVID-19. Rekomandimet kryesisht kanë për qëllim parandalimin duke propozuar zvogëlimin e numrit të personave të privuar nga liria (përmes përdorimit të masave alternative dhe lirimit me kusht etj.) si dhe marrjen e masave me të cilat do të garantohet mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor të personave të privuar nga liria në kushte pandemie.

⁵⁸ European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT), Statement of principles relating to the treatment of persons deprived of their liberty in the context of the coronavirus disease (COVID-19) pandemic - Në dispozicion në: <https://www.coe.int/en/web/cpt/-/covid-19-council-of-europe-anti-torture-committee-issues-statement-of-principles-relating-to-the-treatment-of-persons-deprived-of-their-liberty->



KOMUNITETI LGBTI

Me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe miratimin e masave të para, tashmë mund të vlerësohet se çfarë ndryshimesh do të ndodhin në funksionimin e përditshëm të njerëzve. Kjo njëherit ishte edhe një paralajmërim për pasojat që kjo krizë mund t'i shkaktojë në jetët e më të marginalizuarve. Masat u bënë më të rrepta, me to edhe pasojat mbi shoqërinë dhe mbi njerëzit u bënë më të shprehura. Udhëzimet për mbrojtje, që fillimisht kishin të bënë kryesisht me distancimin fizik dhe vetizolim, më vonë u shndërruan në masa më të rrepta që çonin drejt vetizolimit të detyruar, orë policore më të rrepta dhe më të zgjatura. Në kushte të këtilla, më të rrezikuar janë ata që gjenden në margjina, ata që nuk kanë status të privilegjuar në shoqëri dhe këto janë më së shumti të goditur nga të gjitha masat dhe ngjarjet. Ajo që është e rëndësishme të përmendet në këtë kontekst është se mungesa e mbështetjes, mungesa e masave udhëzuese dhe masave që nuk përjashtojnë askënd, shpesh mund të kenë pasojë të thella dhe të përhershme mbi jetët e më të prekurve.

Kushtet e vetizolimit dhe orët e gjata policore janë sfida për njerëzit LGBTI, sidomos për ata njerëz për të cilët „të jesh ai që jam“ zakonisht nënkupton të jesh jashtë shtëpisë. Në një krizë si kjo, kur ka orë policore dhe masa të tjera aktive, këta njerëz pjesën më të madhe të ditës e kalojnë në shtëpi, që shpesh mund të jetë mjedis ku ata nuk janë të hapur, pa mbështetje dhe të përjashtuar dhe në rastin më të keq mund të jenë ekspozuar edhe ndaj dhunës për shkak të mospranimin nga ana e anëtarëve të familjes. Në kushtet e orës së rreptë policore, që për disa fundjavë zgjaste deri në 82 orë, rritet rreziku i dëmtimit serioz dhe pasojave mbi shëndetin mendor të këtyre njerëzve dhe njëashtu ekspozim të vazhdueshëm ndaj dhunës psikike dhe fizike.

Paragjykimet, homofobia dhe transfobia që mbizotërojnë në një pjesë të madhe të popullatës, i shtyjnë njerëzit LGBTI edhe më thellë në margjina. Për këto arsye, komuniteti po përballët me diskriminim që nga mosha e hershme në procesin arsimor dhe shpesh shumë herët e ndërpresin shkollimin. Kjo më vonë reflektohet edhe në kufizimin e mundësive për punësim dhe diskriminim në vendin e punës, që veçanërisht është e shprehur te njerëzit transgjinorë. Për këto arsye, numri më i madh i tyre janë të papunë, punojnë punë me paga të ulëta ose me orar të pjesshëm dhe kështu jetojnë në një pasiguri të madhe. Vështirësi shtesë paraqiten edhe në procesin e gjetjes së vendbanimit, në procesin e marrjes së shërbimeve ku përsëri janë të diskriminuar për shkak të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor, si dhe në procesin e mbrojtjes nga shkeljet e të drejtave dhe mbrojtjes nga dhuna.



СИГУРНА КУКА SHTËPIA E SIGURTË SAFE HOUSE

Gjendja dhe statusi në shoqëri janë ngusht të lidhur me shkallën e pasojave që situata e krizës do t'i ketë mbi këtë grup konkret. Kjo pandemi solli pasoja serioze në ekonomi dhe në standartin jetësor të njerëzve. Kriza rezultoi me largime masive nga puna të punonjësve/eve, humbje të pjesës më të madhe të të ardhurave për shumicën e njerëzve dhe thellimi i standardit të ulët dhe varfëria.

Me humbjen e vendeve të punës dhe të ardhurave kryesore, pjesa më e madhe e njerëzve erdhën në prag të ekzistencës, kurse për njerëzit LGBTI në masë të madhe do të thotë edhe kthim në shtëpi ku janë të gjykuar dhe të papranueshëm ose duke kërkuar strehim dhe mbështetje nga shërbime të ofruara nga organizatat joqeveritare. Për më tepër, kushtet e vështira të jetesës që kjo krizë ua imponoi komuniteteve më të rrezikuara, janë ngusht të lidhura me pasojat mbi shëndetin e tyre mendor dhe fizik. Jeta në kohë pandemie, e cila për çdo ditë sjell rritjen e numrit të të infektuarve dhe të vdekurve, njëherit edhe masa të rrepta për distancim dhe vetizolim për shkak të parandalimit të përhapjes së virusit, në mënyrë serioze mund të godasë shëndetin mendor dhe fizik të njerëzve, sidomos të atyre shëndeti i të cilëve edhe ashtu është i brishtë.

Këshillimi psikologjik në dispozicion i ofruar nga ana e shtetit është kufizuar dhe është ngushtë i lidhur me sigurimin shëndetësor në bazë të punësimit. Sistemi përmes të cilit ofrohet këshillimi psikologjik është vendosur në atë mënyrë që paraprakisht të vlerësohet këshillimi psikologjik nga ana e mjekut amë, i cili nëse vlerëson se ka nevojë për vizitë të psikologut, jep fletudhëzim përmes sistemit „Termini im”, që më pas në bazë të këtij fletudhëzimi personi të përfitojë mundësinë e vizitës te psikologu. Ajo që është problematike në këtë sistem është fakti se në praktikë mjekët amë shumë rrallë vlerësojnë se një person ka nevojë për këshillim psikologjik, prandaj jo rrallë në vend të këshillimit si zgjidhje përshkruajnë barna për qetësim. Pastaj, ajo që më tepër e vështirëson aksesin në mbështetjen e nevojshme psikologjike është fakti se sistemi i rezervimit të termineve është i tejngarkuar, numri i psikologëve është i pamjaftueshëm, andaj edhe koha e pritjes është e gjatë. Kur gjithë kësaj i shtohet fakti se personi kur përfundimisht do të vie në terminin e

резервуар, i ofrohet numër i kufizuar takimesh me psikologun në shpenzimin e fondit shtetëror dhe faktit se në shtetin tonë ekzistojnë shumë pak psikologë që janë të sensibilizuar dhe trajnuar të punojnë me komunitetin LGBTI, është e qartë se sa është efikase dhe efektive kjo mbështetje shtetërore.

Për më tepër, shteti nuk ka ofruar shërbime për mbështetjen e njerëzve të Komunitetit që janë në rrezik nga mungesa e strehimit dhe që janë viktime të dhunës për shkak të orientimit të tyre seksual dhe/ ose identitetit gjinor dhe që një mbështetje e tillë deri më tani është ofruar nga ana e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale përmes mbulimit participativ të një pjese të shpenzimeve për qendrën e kujdesit – Shtëpia e sigurt për njerëzit LGBTI është hapur dhe menaxhuar nga ana e Qendrës për mbështetje LGBTI. Për fat të keq, me paraqitjen e krizës, vazhdimi i kësaj mbështetje u pa e pasigurt, sepse të gjitha vendimmarrjet e Ministrisë për momentin janë anuluar.

Për momentin, organizatat joqeveritare po i përdorin kapacitetet e tyre të kufizuara për t'i minimizuar pasojat e kësaj krize për njerëzit LGBTI, duke u ofruar akomodim në Shtëpi të sigurt, duke mbledhur donacione, ofruar vullnetarisht këshillime psikologjike ose duke riprogramuar programet aktuale, duke ofruar ndihmë juridike falas dhe duke përdorur mediat sociale dhe platformat online për mbështetje dhe socializim.

Хелсиншки комитет за човекови права и ЛГБТИ Центар за поддршка

Бесплатна правна помош за ЛГБТИ луѓе во сите области (дискриминација врз основа на СОРИ, говор и дела од омраза врз основа на СОРИ, родово-базирано насилство, работнички права).

Едукација и подигнување на капацитетите на ЛГБТИ млади и нивните поддржувачи преку **онлајн тренинг за човекови права, застапување и креативен активизам** кој ќе се одржи во периодот од 18 до 22 мај.

Поддршка на иницијативи во областа на ЛГБТИ/квир културата преку **втор циклус на мали грантови во областа на ЛГБТИ културата и уметноста**. Повикот ќе биде отворен за сите млади луѓе од 18 до 30 години и ќе биде објавен на 1 мај.

Веб: <http://lgbti.mk/> и <https://mhc.org.mk/>

Е-пошта: info@lgbt.mk

Телефон: +389 (0)2 3119 073, 072/

278-436, за време на пандемијата секој работен ден од 09.00 – 14.00 часот



VEPRIMI INSTITUCIONAL

Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme, ora policore si dhe të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin dhe mbrojtjen nga virusi në tërë territorin e vendit tonë, nënkuptonte edhe rritje të kompetencave dhe autorizimeve të nëpunësve policorë. Këto rrethana sollën deri në mënyrën selektive të veprimit të policisë, respektivisht mënyrë selektive në ndëshkimin e qytetarëve që nuk i kanë respektuar masat e Qeverisë. Kështu për shembull, mosveprimi i policisë ishte vërejtur në muajin maj kur në territorin e Komunës së Strugës ishte organizuar manifestim fetar në prezencë të mbi 300 qytetarëve, pa i respektuar masat e Qeverisë. Kjo ngjarje në mënyrë të konsiderueshme e rrezikoi shëndetin publik dhe pas mbajtjes së saj ishte vërejtur rritje e numrit të personave të infektuar në këtë territor. Policia këtë manifestim nuk e kishte ndaluar nga frika e reagimeve të ashpra të besimtarëve të pranishëm në ngjarje. Qeveria e obligoi Ministrinë e Punëve të Brendshme të konstatojë përgjegjësi të nëpunësit policorë të përfshirë në këtë rast, kurse Prokuroria Publike për këtë rast të formojë lëndë në bazë të zërit të dëgjuar.

Paraprakisht, disa javë më herët, në mediat sociale me shpejtësi të madhe ishte shpërndarë një video-regjistrim të nëpunësve policorë të cilët pa maska mbrojtëse privojnë nga liria një djalosh me kafshën e tij shtëpiake, të cilin e takuan jashtë në kohën derisa ishte në fuqi kufizimi i lëvizjes së qytetarëve. Përpos këtij rasti ishin regjistruar edhe shumë raste të tjera kur qytetarë për shkaqe të arsyeshme ishin zënë jashtë shtëpive të tyre gjatë kohës së orës policore, dhe policia u kishte inicuar procedura penale, verdikti i të cilave gjithmonë ishte lëshimi i urdhërit ndëshkimor në shumë prej 2000 euro. Nga ajo që munda të regjistrojë Komiteti i Helsinkit ishte gjykuar dhe dënuar një person i sëmurë kronik që vuante nga astma, i cili gjatë orës policore ishte nisur drejt shtëpisë së motrës së tij për të marrë ilaç për sëmundjen e tij, person të cilin gjatë kthimit për në shtëpi e kanë takuar policët 20 minuta para fillimit të orës policore, ndërsa kthehej nga shtëpia e gjyshes së saj për të cilën kujdesej, e punësuar në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila ishte vonuar pas përfundimit të orarit të saj të punës dhe vendi i saj i punës kishte qenë jashtë territorit të vendbanimit të saj etj. Të gjithë këto persona ishin dënuar me nga 2000 euro, dhe në asnjë rast nuk kishin paraqitur rrezik, madje as nuk e kishin rrezikuar fare shëndetin. Si rezultat i kësaj, është e qartë se policia fare nuk i kishte marrë parasysh rrethanat dhe arsyet pse këto qytetarë nuk i kishin respektuar masat e Qeverisë. Për më tepër, të shpeshta ishin edhe denoncimet e qytetarëve, por edhe raportimet e mediave duke takuar nëpunës policorë të cilët nuk i respektojnë masat e Qeverisë, si për shembull prezenca e tyre në ahengje të organizuara të dasmave që shkaktoi revoltë të madhe të opinionit dhe lindi dyshimi nëse këto nëpunës do të përgjigjen për veprimet e tyre.

Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Qeveria miratoi një sërë masash me qëllim të minimizimit të pasojave negative që gjendja e jashtëzakonshme do të mund të shkaktojë mbi punëdhënësit dhe punëtorët. Megjithatë, disa punëdhënëse, duke e keqpërdorur gjendjen e jashtëzakonshme filluan masovikisht t'ua anulojnë kontratat e punësimit grupeve të tëra të punëtorëve, kurse atje ku kishin mundësi ndikonin mbi to për ndërprerje të marrëdhënies së punës me marrëveshje ose punëtorëve nuk ua vazhdonin kontratat e punësimit për kohë të caktuar. Në këto kohëra jashtëzakonisht të vështira dhe të paparashikueshme filloi edhe lufta për ekzistencën këtyre grupeve të punëtorëve që pavarësisht se si i kanë humbur vendet e punës, mbetën edhe pa paga. Për këtë arsye ata u kthyen drejt ushtrimit të të drejtave të sigurimit që u takojnë në rast papunësie.

Për çdo ditë rritej numri i rasteve ku punëtorët ngelnin pa punë për shkak të ndërprerjeve të imponuara me marrëveshje të marrëdhënies së punës, ose mosvazhdimet të kontratave të punësimit për kohë të caktuar. Zgjidhja aktuale ligjore nuk parashikon ushtrimin e të drejtës për kompensim monetar në rast papunësie për këtë kategori punëtorësh, prandaj Qeveria në paketën e saj të tretë të masave ekonomike miratoi masën „Kompensim monetar për të

gjithë personat që kanë mbetur pa punë në periudhën prej 11 mars deri më 30 prill 2020 “.

Një pjesë e punëtorëve që kërkuar ndihmë juridike nga Komiteti i Helsinkit na njoftuan se gjatë përpjekjeve për ta ushtruar të drejtën e kompensimit monetar në rast papunësie, në përputhje me Ligjin për punësim dhe sigurim në rast papunësie si dhe në përputhje me masën e paketës së tretë të masave ekonomike të Qeverisë u përballën me disa probleme dhe mospërputhje. Në fakt ishte vërejtur se qendrat për punësim nga rajone të ndryshme të vendit tonë kishin praktika të ndryshme gjatë procesit të vendimmarrjes për lëndë të tilla. Për këtë arsye, Komiteti i Helsinkit parashitri propozim-kërkesë në Agjencinë për punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut që të përpilojë, miratojë dhe shpallë udhëzime konkrete për zbatimin e të gjitha masave të miratuara qeveritare që i prekin qytetarët, për të drejtat e të cilëve vendos Agjencia, mirëpo përgjigje kthyese nuk pranuan.



Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve

Shpallja e pandemisë KOVID-19 padyshim kishte ndikim të madh në mënyrën e menaxhimit të sistemit penitenciar. Në mënyrë të ngjashme sikur në shumicën e vendeve evropiane dhe të rajonit, një pjesë e të drejtave dhe përfitimeve që paraprakisht i kanë gëzuar personat e privuar nga liria, ishin kufizuar. Si rezultat i kësaj, kontaktet me botën e jashtme, më saktë vizitat dhe ushtrimi i të drejtave që parashikojnë dalje ose mungesë nga institucioni në një periudhë të caktuar kohore, ishin ndaluar plotësisht. Komiteti i Helsinkit kërkoi të dhëna për mënyrat alternative se si kompensohen këto të drejta, mirëpo përpos një përgjigjeje individuale nga ENK Burgu Shkup, deri në çastin e publikimit të këtij raporti nuk kemi pranuar asnjë përgjigje. Për më tepër, sa i përket situatës me ENK Burgu Kumanovë, ku persona të gjykuar u ankuan për mungesë të ujit për mbajtjen e higjienës, nuk është pranuar asnjë njoftim në lidhje me kërkesën për mbikëqyrje të jashtëzakonshme që ishte dërguar nga ana e Komitetit të Helsinkit.

Për periudhën që ky raport i referohet, nuk u lejuan vizita monitoruese në institucionet ndëshkuese-korrigjuese. Duke u nisur nga parimi „të mos shkaktohet dëm“ (do no harm), Komiteti për Parandalim nga Tortura në opinionin e tij për trajtimin e personave të privuar nga liria rikujton se „monitorimin që e kryejnë institucionet e pavarura, përfshi edhe Mekanizmin Kombëtar të Parandalimit (MKP) dhe KPT-në edhe më tej është mekanizmi kryesor për mbrojtje kundër trajtimit jonjerëzor“. Si rezultat i kësaj, KPT-ja thekson se „shtetet edhe më tej duhet t’ju garantojnë akses të gjitha organeve për monitorim në të gjitha vendet ku janë vendosur personat e privuar nga liria, përfshi edhe vendet ku janë vendosur persona në karantinë. Të gjitha organet e monitorimit duhet t’i ndërmarrin të gjitha masat e kujdesit, me qëllim që të respektojnë parimin, të mos shkaktohet dëm“, veçanërisht kur punojnë me persona në moshë dhe persona që kanë probleme ekzistuese shëndetësore“.

